

Dëshmi e vetë-vullnetshme, publike, për ZPS-në e Republikës së Kosovës [dërguar ZPS-së përmes e-mailit zyrtar.]

Për shkak të irritimit që po më shkakton fushata e orkestruar, e cila ka marrë përmasat e një lufte speciale, diverzive, kundër institucioneve të Drejtësisë së Republikës së Kosovës – Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe Dhomave të specializuara (DHS), po e ndiej për obligim qytetar dhe patriotik të ofroj këtë dëshmi, me shpresë se ZSP-ja do ta marrë parasysh.

Qysh në fillim dëshiroj të shpreh falënderimin ndaj BE-së dhe SHBA-vë, që u angazhuan me kaq përkushtim, duke harxhuar shumë financa e kuadro profesioniste, për t'i krijuar këto institucione, të cilat do të hetojnë e gjykojnë akuzat që i përmban Raporti i parlamentarit zvicëran Dick Marty.

[Për ata që nuk e dinë, ky Raport është votuar nga Këshilli i Europës (KE), më 7 janar 2011. Ndërsa më 25 janar 2011 është votuar rezoluta për të filluar hetimet e atyre akuzave.]¹

Marionetat e shërbimeve nacionaliste serbe, ruse e simotrave të tyre, janë duke zhurmuar tani në mënyrë të orkestruar kundër ZPS-së dhe DHS-së, me qëllim të nxitjes së trazirave të turmave injorante në Kosovë, të cilat, fatkeqësisht, gjithandej bien kollaj pre e luftërave speciale të shërbimeve armiqësore, por edhe të teorive të

¹ Asambleja parlamentare e Këshillit të Europës ka 380 parlamentarë të delegacioneve parlamentare të 47 shteteve anëtare. Në seancën e 25 janarit 2011, kur është votuar rezoluta për të hetuar akuzat e Raportit, 166 kanë votuar pro, 8 kundër, 9 kanë abstenuar. [Pro kanë votuar edhe dy parlamentarë (PD dhe LSI) përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, ndërs dy tjerë (PS) kanë votuar kundër.]

<https://www.evropaelire.org/a/2286418.html>

kompleteve. Kjo fushatë është **anti** Kosovë dhe **anti** Ushtrisë
Çlirimtare të Kosovës (UÇK)!

Dëshmi konkrete e kësaj fushate destruktive është Baton Haxhiu, marioneta e Jovica Stanishiqit, ish-kryeshefit të shërbimit inteligjent të Serbisë, i quajtur Resor Drzavnog Bezbednosti - RDB / РДБ.² Për të nxitur trazirat Baton Haxhiu dhe silloji i tij, po zhurmojnë gjithandej nëpër emisione speciale televizive, kinse të shqetësuar që “Gjykata speciale” qenkësh themeluar ekstra për ta komprometuar UÇK-në dhe Luftën e saj të drejtë çlirimtare. Për këtë arsye, gjithënjë sipas tyre, ZPS-ja i ka akuzuar “udhëheqësit” dhe “liderët” kryesorë të UÇK-së.

Viktimave, të mashtruar e të përvetësuar nga kjo luftë speciale kundër ZPS-së dhe DHS-së, dua t’ua përkujtoj se Rusia, Serbia dhe miqtë e tyre, janë ndjerë të mjaftuar me gjykimin që i kanë bërë Kosovës dhe UÇK-së, me 7 janar 2011, në KE, - me ç’rast, tërthorazi, e kanë gjykuar e komprometuar edhe Alenacës NATO. Prandaj Serbia dhe Rusia nuk kanë qenë të interesuara për formimin e institucione që do t’i hetonin e gjykonin akuzat në Raportin e Martit, sepse kanë qenë të bindura se ato akuza do të demantoheshin e diskreditoheshin, si shpifje politike. Këtë e dëshmon edhe mosgatishmëria e tyre për të dhënë ndihma financiare për institucionet që do të hetonin akuzat e Raportit të Martit.

Tash, meqë ZPS-ja dhe DHS-ja janë formuan, falë angazhimeve të BE-së e SHBA-së dhe mençurisë pragmatike të shumicës së parla-

² Vet Baton Haxhiu ka rrëfye se ishte „ndërmjetësues“ i takimeve mes Jovica Stanishiqit e Mahmut Bakallit (ish kryetarit të Komitetit Krahinor të Lidhjesw Komuniste të Kosovës.

RDB është akronim i riemërtimit, më 13.03.1991, të ish UDB-së dhe SDB-së, me kryeshef Jovica Stanishiq, deri më 26.10.1998, i pasuar nga Radomir Markovićqi, nga 27.10.1998 – 25.01.2001. Në këtë tekst të dëshmisë do të përdori vetëm akronimet në serbisht, me gërma latine, sepse akronimet në origjinalin cirilik apo përkthimi i tyre në shqip, e vështirëson kuptushmërinë e kësaj dëshmie.

mentarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shërbimet serbe dhe simotrat e tyre janë angazhuara për t'i sabotuar e minuar këto institucione, me trazira sa më të fuqishme të turmave të mashtruar në Kosovë. Serbia dhe Rusia nuk duan të identifikohen krimet që duhet t'i kenë bërë individët e UÇK-së dhe jo UÇK-ja, por duan të mbetet gjykimi e kompromentimi kolektiv që përmban Raporti i zvicërnait Marty, fatkeqësisht i miratuar nga Këshilli i Europës.

Duke u akuzuar “udhëheqësit”, “liderët”, “krerët”, “komandantët”, në dukje po imponohet keqkuptimi sikur vërtet ka ekzistuar komanda qëndrore ushtarake që e ka komanduar UÇK-në, për të bërë krime, edhe monstroze, kundër civilëve serbë, kundër minoriteteve të tjera dhe kundër kundërshtarëve politikë shqiptarë.

Unë do të dëshmoj se të akuzuarit Hashim Thaçi / “Gjarpni” dhe Rexhep Selimi / “Dheshi”, vërtet ishin “ndërmarrje e përbashkët kriminale” (NPK), por ajo NPK ishte anti UÇK dhe anti Luftës çlirimtare. Fatkeqësisht shërbimet armiqësore na i kishin penetruar në UÇK anëtarët e NPK-së. Shpresoj që edhe krye-kapot Xhavit Haliti / “Zeka” dhe Azem Syla / “Daja”, që i përkisnin asaj NPK-je, do të akuzohen dhe do të burgosen sa më shpejt.

Që të karikohem me guxim për ta ofruar këtë dëshmi po e citoj shkrimtarin Victor Hugo:

*Do të vuaj, do të duroj pa u penduar kurrë,
Pa shikuar të tjerët nëse qëndrojnë apo jo,
Nëse u përkul ndokush që e pandehnim për burrë,
Nëse ikin shumë veta që s'u ka hije kjo.*

*Njëmijë në qëndrofshin, do të qëndroj dhe unë,
Po dhe njëqind në mbetshin, nuk tundem kurrsesi,
I dhjeti do të jem po qe se mbeten dhjetë!*

E në mbettë veç një - do të jem unë ai!

E quaj të nevojshme të sqaroj se kam nevojë për karikim me guxim, meqë qe më shumë se 40 vjet po i sfidoj kërcënimet, sharjet, denigrimet, që i kanë orkestruar shërbimet policeske të RFS të Jugosllavisë, RS të Serbisë, KSA të Kosovës, por edhe kërcënimet që i kanë orkestruar marionetat e tyre të penetruara, para vitit 1990 në Lidhje Komuniste të Jugosllavisë (LKJ), pas vitit 1990 në pasuesen e saj, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), por edhe në Lëvizje Popullore të Kosovës (e afirmuar me akronimin LPK; unë do përdor emërtimin Lëvizje në këtë tekst) dhe në UÇK.

Informim për ata që nuk e dinë: më 27 shkurt 2020 ma kanë vrarë barbarisht vëllain, **Qerimin**.³ Logjike është që një pistë e dyshimit është shërbimi nacionalist-fashistoid serb BIA,⁴ e cila, pasi ka bërë shumë vjet luftë speciale kundër Qerimit, tani e ka gjet momentin e volitshëm për vrasjen e tij, për qëllime hakmarrëse dhe për të nxit huti dhe frikë. Disa ditë para vrasjes së Qerimit, përmes mediave dhe “opinionistëve” në Kosovë, BIA pat konkretizuar edhe shpifje, kinse Qerimi ishte dëshmitar i mbrojtur i ZPS-së. Në atë luftë speciale, më specialisti qe dëshmuar marioneta Baton Haxhiu, që pat bërë “intervistë” televizive me një kriminel (Shkumbin Mehmeti), të dënuar 30 vjet burg për vrasje të policëve. Shkumbin Mehmetit, në ndërkohë, i është dhënë statusi i dëshmitarit të mbrojtur! Por ky status ligjor nuk ishte pengesë për Baton Haxhiun që ta “intervistonte” atë dëshmitar të dresuar.⁵

³ <https://gazetablic.com/vrasje-e-qerim-kelmendit-rrefehen-familjaret-e-tij-pas-ngjarjes/>

⁴ Shërbimi i tanishëm inteligjent i Serbisë prezantohet me akronimin BIA, ndërsa emri origjinal e ka Bezbednosno-informativna agencija/agjensia informative për siguri, është riemëritim/riorganizim i RDB-së pararendëse, më 2002, e cila ishte pasuese e SDB-së famoze të Jugosllavisë socialiste.

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=s7H1CpfP6vc>

Uroj që institucionet kompetente t'i zbulojnë vrasësit dhe urdhër-dhënësit për vrasjen e Vëllait Qerimit, por edhe të të gjitha vrasjeve politike, që nuk po zbulohen që më shumë se dy dekada!

Për informim të ZPS-së po ofroj biografi telegrafike: Jam i lindur më 23.06.1954, në fshatin Llabjan të Pejës. Në verë të vitit 1976, pasi frekuentova semestrin e 6 në Fakultetin e Fizikës, në Prishtinë, jam arratisur nga Kosova.

Në Gjermani gjatë viteve 1977-1982 isha student në Ruhr-Universität në Bochum, drejtimet germanistikë dhe filozofi. Paralelisht jam angazhuar në veprimtari çlirimtare për Kosovën.

Në gusht 1978, me insistim të Xhevat Ramabajës, katër veta kemi themeluar organizatën: Fronti i Kuq Popullor (FKP). Pas disa muajve të veprimtarisë jam bindur se Xhevat Ramabaja ishte spiun i SDB-së jugosllave, i penetruar si informator në Partinë Komuniste Gjermane KPD/m-l (e cila kishte për idol kryesor Mao Cedunin dhe Enver Hoxhën). Ajo parti furnizonte imigrantët shqiptarë me literaturë propagandiste nga Shqipëria, prandaj Xhevati duhej të survejonte nëse po anëtarësoheshin imigrantët shqiptarë nga Jugosllavija në atë parti.

Emërtimi i organizatës me atë emër aq eksploziv, u bë me insistimin e Xhevatit, si kaudër i SDB-së.

Më pastaj isha bashkëveprimtar i Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Më 17 Janar 1982, në Gjermani, e themelua **Lëvizjen për Republikën e Kosovës**. Marionetat e SDB-së, Sabri Novosella dhe Avduallah Prapashtica, më 17 shkurt 1982, e komplotuan, duke sajuar "bashkimin" në LRSSHJ, përkatësisht LRSHJ.

Në vitin 1987, kur ia dolëm t'i izolonim marionetat e SDB-së, Novosellën dhe Prapashticën, organizatën e emërtuam Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Në tetor 1991 e riemërtuam: Lëvizja popullore e Kosovës (LPK).

Platforma politike e Lëvizjes, deri në vitin 1990, kur filloi të zhbëhej Federata e Jugosllavisë, ishte vetëm barazia nacionale e sociale, e shqiptarëve me popujt e tjerë në Federatën RSFJ, e përmbledhur në kërkesën **Kosova-Republikë**, siç e kishin 6 popujt e tjerë në Jugosllavi (Me madhësi numerike, shqiptarët ishin popullit i tretë në Jugosllavi).

Më 27 korrik 1993, kur konstatuam se “rezistenca paqësore” nuk po e sillte çlirimin, tashmë të Republikës Kosovës, të cilën e kishte shpall Parlamenti i Kosovës më 2 korrik e 7 shtator 1970, Lëvizja mori vendim për themelimin e “krahut” të saj të armatosur çlirimtar, të cilin, më 17 nëntor 1994, e emërtuam: **Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)**.

Lëvizja e orientoi UÇK-në politikisht, e ndihmoi financërisht, me infrastrukturë logjistike dhe me kuadro komanduese.

Gjatë viteve 1982 – maj 1998 isha në udhëheqje të Lëvizjes, në pozitën e anëtarit të Këshillit të Përgjithëm të saj (KP). Në maj 1998, Mbledhja e 6-të e përgjithshme (M6P) më ka zgjedhë, pos anëtar i KP, edhe anëtar të Kryesisë së Lëvizjes. Këtë pozitë e kam mbajtur deri në fund të qershor 1999, kur M7P, gjegjësisht mbledhja e fundit e Lëvizjes, mori vendim për ta zhbërë Lëvizjen.

Pas Çlirimit të Kosovës “kryeministri” Hashim Thaçi më pat lut të ushtroja ndonjë funksion në “qeveri të përkohshme” apo në kabinetin e “kryeministrit”, por nuk kam pranuar për shumë arsye, ndër të cilat nuk doja që Kosova të akuzohej se po udhëhiqet nga ish “ekstremistët”, “terroristët”, për shkak se kisha qenë bashkë-for-

mues i FKP-së (meqë shërbimet e Perëndimit, të cilat e mbronin Jugosllavinë nga kundërshtarët politikë pothuajse më shumë se SDB-ja jugosllave, siç ishte edhe shërbimi gjerman BND, që kishin sajuar “dosje të zezë” edhe për mua), por edhe spese nuk doja të komprometohesha duke u bërë kolegë me marionetë të shërbimeve armiqësore...

Zhurma e orkestruar politike kundër ZPS-së dhe DHS-së, fatkeqësisht u sforcua pas publikimit të aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe kur ndodhi arrestimi i tyre. Kryeprokurori amerikan, Z. Jack Smith, i akuzoi ata si “Ndërmarrje e përbashkët kriminale”, pikat 32 dhe 35 e aktakuzës (Në tekst të mëtejme do ta përdori akronimin: NPK).⁶

Për momentin, unë vetëm Hashimin dhe Rexhepin do t’i diskualifikoj si kapo të NPK-së (përpara kam përdorur emërtime pezhorative, si: “Bandë e krimit të organizuar”, “Shtabi i Rognerit”, etj.)⁷. Këta, duke mashtruar se ishin “udhëheqës politikë” e “komandantë ushtarakë”, u penetruan në UÇK, por komanduan vetëm ca argatë të NPK-së, nuk ia dolën ta Komandonin UÇK-në. Ata kushtimisht ishin kundër UÇK-së dhe luftës së saj të drejtë çlirimtare.

Bashkëveprimtarët më të ngushtë të Hashimit dhe Rexhepit ishin Xhavit Haliti dhe Azem Syla. Shpresoj se ZPS-ja së shpejti do të ngritë aktakuzë edhe kundër tyre. Jakup Krasniqi dhe Kadri Vesli, ndërkaq, për bindjen time momentale, ishin dhe janë viktima të NPK-së.

⁶ Po e përdori verzionin e shqipëruar të aktakuzës, meqë nuk e zotëroj gjuhën anglishte.

⁷ Rogner e ka emrin një hotel austriak, buzë Kryeministrisë, në Tiranë, dhe, meqë Xhavit Haliti e kishte aty qerdhen e takimeve komplotiste, është sajuar ky emërtim pezhorativ.

1. Vrasja e spiunëve dhe kundërshtarëve politikë

Në fushatë kundër ZPS-së dhe DHS-së po shpërdoret akuza që u është bërë të akuzuarëve si NPK, e cila paskësh vrarë apo urdhëruar vrasjen edhe të kundërshtarëve politikë. Kjo fushatë tani mund të eskalojë në vrasje hakmarrëse apo në vrasje të dëshmitarëve, por edhe të të dyshuarëve për dëshmitarë.

1.1. Qysh në fillim dua ta bëj këtë sqarim: Sipas frymës, mendimit, orientimit, qëndrimit të LPK-së, të bartur në UÇK, pjesëtarët e UÇK-së nuk kanë guxuar të vrasin apo të keqtrajtojnë asnjë kundërshtar politik, shqiptar apo të etnive të tjera; ndërsa spiunët dhe diversio-nistët e forcave pushtuese serbe, me përkatësi shqiptare apo të etnive të tjera, nëse nuk dë të mund të pengoheshin dhe izolohe-shin, në momentin e fundit, kur ua rrezikojnë jetën ushtarëve çli-rintarë dhe popullsisë civile, duhet të vriten, siç është praktikë në luftërat çlirimtare të popujve të pushtuar, kur nuk kanë institucione të tyre të drejtësisë dhe mundësi të tjetëra.

Duke u munduar të kujtoj konkretisht vrasje të ndonjë spiuni, më shkoj mendja të fqinji im i parë, në vendlindje, të cilin e kisha bashkëmohatar por edhe kusherinën e tij e kisha kunatë të çmuar. Emri i tij: Skendër Kuqi, i fshatit Lutogllavë, Komuna e Pejës.

Mbesa e Skendër Kuqit, e cila jetonte pranë kryeqytetit gjerman Bonn, ishte angazhuar vullnetarisht në Zyrën e Fondit “Vendlindja thërret” (FVTH).⁸ Ajo regjistronte në *datbaz* emrat e donatorëve dhe sasinë e donacionit. Skenderin e kujtova edhe për shkak se, më 16 korrik 1998, përjetova një keqardhje ekstra. Atë ditë nuk isha në zyrë të Fondit. Mbesa e Skenderit, prandaj, më pati telefonuar për

⁸ Fondi „Vendlindja thërret ndonjëherë në gjuhë të huaja është përkthyer “Atdheu thërret”, për t’i ngjarë sloganit nazist “Heimat ruft” / Atdheu thërret. Pra, në shqip dhe në gjuhë të huaja nuk janë njësoj vendlindja dhe atdheu.

t'më informuar se po shkonte menjëherë të prindërit, meqë e kishin marrë lajmin se "UÇK-ja e ka vra spiunin Skender Kuqi".

Ajo mënyrë e informimit më tronditi. Mbesa e Skenderit po angazhohej me përkushtim për UÇK-në, ndërsa UÇK-ja ia vrau xhaxhain. Në internet e gjeta informimin "zyrtar": Aktgjykimin e Ramush Haradinajt..., të Gjykatës së Hagës.⁹ Nën shifrën 519 dhe 520 të atij aktgjykimi shkruan:

"Në Aktakuzë gjithashtu pretendohet se më 11 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Skënder Kuqi, shqiptar kosovar, u rrëmbye nga dyqani i tij në Zahaq prej ushtarëve të UÇK-së dhe u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku ushtarë të UÇK-së e rrahën keqazi me shkopinj dhe shufra hekuri. Pretendohet se më 16 korrik 1998, Skënder Kuqi u dërgua në qendrën shëndetësore të UÇK-së në Irzniq ku edhe vdiq. Sipas akuzave në Aktakuzë, si pasojë e rrahjeve atij i shihej veshka prej një plaje të hapur. Pretendohet se kufoma e tij u varros nga ushtarët e UÇK-së në Jabllanicë dhe se më vonë me udhëzim të Ramush Haradinajt, kufoma e tij u zhvarros dhe iu dha familjes së tij."

Druaj se, nëse Ramush Haradinaj do të bëhej fajtor e do të dënohej për vrasje të Skenderit, meqë ishte komandant i UÇK-së në zonë të Dukagjinit, do të mund të kishte pasuar vrasje "hakmarrëse" kundër familjarëve të Skenderit.

Me këtë konkretizim desha t'ua bëj një këshillë hetuesve, prokurore, gjyqtarëve, që të kenë parasysh se vrasjet e spiunëve të forcave pushtuese gjatë lufte, siç ka ndodhur në të gjitha luftërat çlirim-

⁹ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991, më 29 nëntor 2012, Lënda: IT-04-84bis-T 305/8148QUATER D305 - 1/8148QUATER.

tare të popujve të pushtuar, nuk mund të trajtohen thjesht si vepra kriminale. Në Francë, ta zëmë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, janë vrarë, pa hetim e gjyq, mijëra kuislingë e kolaboracionistë të nazizmit. Fatkeqësisht janë vrarë e linçuar edhe shumë gra franceze, që kishin pas “marrëdhënie” me pushtuesit nazistë.

UÇK është përmbajtur gjatë dhe pas lufte. Deri tani, nuk di të ketë vrarë, qoftë vetëm një kuisling e kolaboratoricionist millosheviqian, edhe pse ishin shumë sish, që Millosheviqi i kishte angazhuar apo i toleronte si udhëheqës të “rezistencës pacifiste” të shqiptarëve.

1.2. Në vitin 1992 në Shtutgart / Gjermani iu bë gjyq imigrantit Riza Salihu (shqiptar nga Kosova nga Mushitishta e Suharekës). Unë isha dëshmitar. Riza Salihu dyshohej për vrasje të shkrimtarit Jusuf Gërvalla, punëtorit social Bardhosh Gërvalla (i cili punonte në Arbeiterwohlfahrt të Gjermanisë në Ludwigsburg) dhe gazetarit Kadri Zeka, ekzilant në Zvicër, më 17 janar 19982, në Untergruppenbach të Gjermanisë.

Kur shkova në atë senacë gjyqësore, Riza Salihu, i cili ishte në burg hetues mbi 18 muaj, simuloi sëmundje psiqike për të dështuar ajo seancë. Ai donte t’i ikte ballafaqimit më mua.

Kryetari i trupit gjykues, pasi mbylli seancën e dështuar, na rrëfeu: “Kur u caktova për ta shqyrtuar këtë lëndë, konsultova literaturë për angazhimet e shërbimeve jugosllave në botë të jashtme, gjegjësisht për vrasjet e kundërshtarëve politikë, që ishin ekzilantë në shtetet e Perëndimit. Erdha në përfundim se vrasësit duhej të kishin etni të njëjtë me të vrarët dhe, nëse zbulohen, duhej të simulonin të sëmurin psiqike, si ky që përjetuam sot; vrasësi dhe viktimi, pra, duhej të ishin të së njëjtës etni në mënyrë që shërbimet të shpifin, pastaj, se ishte vrasje mes kundërshtarëve politikë, apo se vrasësi ka bërë vrasjen për shkak të sëmundjes psiqike...” [parafrazim]

Kujtova këtë ndodhi, për të informuar prokurorët e ZPS-së, se shërbimet e Serbisë kanë dhe kishin përvijim operativ, që për vrasje të kundërshtarëve të angazhonin vrasës të të njëjtës etni, për t'i prezantuar vrasjet si vrasje mes kundërshtarëve politikë.

1.3. Më 31 tetor 1999, në Prishtinë pat ndodhur plagosja e serbit Momçilo Trajković (serbisht: Momčilo Trajković). Ai ishte lider i nacionalistëve serbë në Kosovë, njëkohësisht ishte marionetë politike e diktatorit Slobodan Millosheviq. Plagosja ndodhi pikërisht në ditën kur ishte paralajmëruar vizita e Komisionerit të BE-së për Politikë të Jashtme, Javier Solana. Atë ditë përjetuam një “shou” zhurmues nga politikanët nacionalistë serbë. Ia dolën t'i bindin Solanen dhe Bernard Kouchner (shef i UNMIK-ut në vitin 1999-2001), se vrasjen e kishin bërë “nacionalistët shqiptarë”.

Në mbrëmje Kouchner u kthye në Paris me aeroplan “special”. Ai i kishte thënë Bardhyl Mahmutit, atëherë “ministër i jashtëm” në të ashtuquajturën qeveri e përkohshme (QPK), se mund të shkonte me të njëjtin aeroplan për ta vizituar Jashar Salihun në klinikë në Paris.¹⁰ Bardhyli pati mirësinë të më merrte me vete. Me z. Couchner kisha njohje. Në aeroplan ishim vetëm ai, Bardhyli dhe unë. Z. Couchner ishte i hidhëruar shumë për plagosjen e Trajkovićit. Meqë komunikim rrjedhshëm në gjermanisht, i folta se nuk kishte kuptim që po na bënte atë shërbim, e të mos na fliste fare. Ai shprehu dufin: “Si mos të hidhërohem për turpërimin që ma bëtë sot para Solanës...” Ia ktheva: “Dëgjo, Mik shumë i respektuar, po të ishte shqiptar plagosësi i Trajkovićit, do ia zbrazëte plumbat në gjoks apo në ballë, siç e meriton, dhe jo vetëm një plumb në tul të këmbës. Meqë je me profesion mjek, urdhëro t'i bëhen analiza. Ai ende ka mbetje të narkozës lokale në vendin ku e ka plagos specialisti i shërbimit serb...”

¹⁰ Jashar Salihun e kishim kryetar të Fondit “Vendlindja thërret” dhe nënkrytar në Kryesinë e LPK-së (edhe unë e Bardhyl Mahmuti ishim anëtarë të Kryesisë).

Z. Couchner nuk ka prit mbarimin e rrëfimit tim. Ka shkuar për disa minuta në kabinë të pilotimit. Kishte dhënë urdhërin që të bëhej ai hetim. Më vonë i ka ardhur konfirmimi, duke qenë ne ende në aeroplan. Aty e tutje Z. Couchner u relaksua për të biseduar me ne.

Zëdhënësi i KFOR-it, Ole Irgens, ka informuar Radion serbe B92: *“Gospodin Trajkovic je bio cuvan od strane KFOR-a 24 sata dnevno. Imali smo vojnike koji su stajali pred njegovim vratima i dodatne mere obezbedjenja oko njegovog stana. Prosle noci on je rekao nasim vojnicima da ne zeli njihovo prisustvo i nikakvu vrstu zastite te veceri. Objasnio je da ima privatne razloge za to. Iako smo bili jako zabrinuti za njegovu bezbednost, morali smo da postujemo njegovu privatnost.”*¹¹

Qysh atë ditë Trajkoviç u zhduk nga skena politike, sepse u zbulua përse ishte bërë ai krim komplotist. Fatkeqësisht z. Couchner as funksionarë të tjerë të UNMIK-ut nuk i publikun të vërtetat për atë lloj komploti të sofistikuar.

Akoma më tragjik ishte komploti serb në fshatin Gorazhdec të Pejës. Më 13 gusht 2003 u vranë dy dhe u plagosën 4 fëmijë sebë: Ivan Jovović (19) dhe Pantelija Dakić (12) u vranë, ndërsa Đorđe Ugrenović (20), Bogdan Bukumirović (14), Marko Bogićević (12) dhe Dragana Srbljak (13) u plagosën rëndë. Prokurori Flamur Kelmendi, në Prokurori të Pejës, më pat thënë, në konfidencë, se vrasësi ishte serb, por UNMIK-u ua ka ndaluar të informojnë. Për atë rast u thirr menjëherë mbledhje e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pra, edhe ajo vrasje dukej se ishte bërë nga kriminelët e BIA-së.

¹¹ Për ata që nuk kuptojnë serbisht, është bërë informimi se vet Trajkoviçiqi, një natë përpara, ka kërkuar të mosw e ruajnë ushtarët e KFOR, për „arsye personale“. Cituar sipas:
https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=1999&mm=11&dd=02&nav_category=1&nav_id=2734

Masakrën e 14 dhjetorit 1998, në lokalitetin “Panda”, në Pejë, në ndërkohë e ka dekonspiruar vetë presidenti i Serbisë Vuçiq. Aty janë vrarë 6 të rinj serbë dhe malazezë. Për këtë vrasje, institucionet millosheviqiane e kanë akuzuar UÇK-në. Janë burgosur, maltretuar e gjykuar shumë shqiptarë. Tashmë, kundër atij krimi askush nuk po ankohet në Serbi, por as miqtë ndërkombëtarë të Serbisë, si Dic Marty, nuk po e “numërojnë” më si krim të UÇK-së. Fatkeqësisht, këtë krim nuk më besohet se do ta procedojë për hetim as ZPS-ja, me arsyetim se nuk është në Raportin e Dik Martit...

I solla këto raste që të dihet se shërbimet serbe, në kuadër të luftës së tyre speciale, diversioniste, nuk i kanë kursyer as fëmijë serbë, sepse me vrasjen e tyre arrinin më shumë suksese. Aq më pak i kanë kursyer shqiptarët. Ato shërbime vetëm kanë zgjedhur, cili shqiptar duhet të vritet, kur dhe ku, që të nxisin sa më shumë armiqësi në mes të shqiptarëve dhe t’i ofrojnë botës “fakte” se UÇK-ja ka vrarë edhe kundërshtarë politikë shqiptarë.

Në kuadër të kësaj taktike, por edhe për ta sabotuar furnizimin e UÇK-së me armë nga Shqipëria, duhet të jetë vrarë në Shqipëri, më 9 maj 1998, edhe Komandanti i UÇK-së, Ilir Konushevc.

Edhe ish-kryetari i Lëvizjes dhe komisar i UÇK-së, Behajdin Allaqi, është “zhdukur” më 11 qershor 1998; është “sekret publik” në Kosovë, siç përdorët si zhargon për raste të ngjashme, se Behajdinin e ka arrestuar Policia Ushtarake e UÇK-së dhe ia ka dorëzuar të prangosur Hashim Thaçit...

Edhe gazetari Enver Maloku është vrarë më 11 janar 1999, për bindjen time, po me urdhër RDB-së së Serbisë, për hakmarrje kundër tij, sepse u pozicionua pro përkrahjes së UÇK-së, dhe për të nxit huti e armiqësi mes UÇK-së dhe pacifistëve rugovistë.

Edhe qindra vrasje politike janë bërë pas përfunimit të luftës, shumica e të cilëve ishin pjesëtarë të UÇK-së. Disa ishin edhe personalitete të LDK-së. Fatkeqësisht lufta speciale në Kosovë ka zhurmuar vetëm për të vrarët që ishin pjesëtarë të LDK-së, por jo edhe për vrasjet e pjesëtarëve të UÇK-së! Pra, Serbia dhe Dick Marty i kanë “problematizuar” vetëm vrasjet e LDK-istëve, por jo edhe vrasjet e pjesëtarëve të UÇK-së.

Nëse vëllai im, Qerimi, do të kishte qenë serb apo pjesëtar i LDK-së, vrasjen barbare të tij Serbia do ta “problematizonte” deri edhe në Këshill të Sigurimit të OKB-së!

Edhe vrasja e Ibush Kllokoqit, më 6 gusht 1999, duhet të ketë qenë vrasje e RDB-së serbe, por kësaj radhe rezulton se vrasjen duhet ta ketë koordinuar Azem Syla, pjesëtar i NPK-së dhe mashtrues - se ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së.

Ibush Kllokoqi ka qenë shef i SDB-së të KSA të Kosovës për Prishtinë dhe ka pas informacion për spiunët e SDB-së. Kjo vrasje është zbuluar dhe gjykuar në Prishtinë.¹²

2. Historiku i UÇK-së.

2.1. Në Akgjykimin e Gjykatës së Hagës për Ramush Haradinajn¹³, në pikat 18 dhe 19, janë “zyrtarizuar” mashtrimet, të bazuara në dëshmi të rrejshme, nga dëshmitarët që janë të evidentuar në fusnotat përkatëse:

“Nga fundi i vitit 1996 dhe fillimi i vitit 1997, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së²⁰ numëronte rreth 10 anëtarë që vepronin në tri

¹² <https://klankosova.tv/arrestohet-bekim-syla-i-denuari-per-vrasjen-e-ibush-kllokoqit/>

¹³ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991, më 29 nëntor 2012, Lënda: IT-04-84bis-T 305/8148QUATER D305 - 1/8148QUATER.

zona të ndryshme: fshehtas në Kosovë, në Shqipëri dhe në shtetet e Perëndimit, si për shembull në Zvicër, Gjermani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francë dhe anembanë Skandinavisë.¹⁴ Deri nga pranvera e 1998, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishin Sokol Bashota, Raif Gashi, Xhemajl Fetahu, Adem Grabovci, Xhavit Haliti, Ilir Konushevc, Jakup Krasniqi, Azem Syla (Sula), Rexhep Selimi, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Xhavit Zeka.¹⁵ Adem Jashari ishte komandant i UÇK-së deri në mars të vitit 1998.¹⁶ Pas vrasjes së Adem Jasharit, komandant i përgjithshëm i UÇK-së u bë Azem Syla (Sula), kurse Sokol Bashota zëvendëskomandant i UÇK-së dhe Rexhep Selimi inspektor i përgjithshëm.¹⁷ Hashim Thaçi drejtonte degën politike të UÇK-së.¹⁸ Jakup Krasniqi u emërua zëdhënës i UÇK-së në Kosovë në qershor të vitit 1998.¹⁹ Bislim Zyrap i bë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dikur

¹⁴ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5025.

¹⁵ Bislim Zyrap, Prova materiale P160, para. 15-16; Bislim Zyrap, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3261, 3265-3267, 3282-3283, 3389; Bislim Zyrap, T. 651, 689, 693, 759-760; Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3305-3307, 3311; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5026-5027, *shih* gjithashtu Rustem Tetaj, Prova materiale P75 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3821.

¹⁶ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5024.

¹⁷ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3311; në lidhje me vrasjen e Adem Jasharit, *shih* më poshtë para. 143.

¹⁸ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3306; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5075.

¹⁹ Jakup Krasniqi, Prova materiale P67 (transkripti *Limaj*), T. 3311-3313, 3429; Prova materiale P65, Shtojca 14. 28

Bislim Zyrap, Prova materiale P160, para. 16; Bislim Zyrap, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3259, 3282, 3304; Bislim Zyrap, T. 687, 695.

nga fundi i majit maj apo fillimi i qershorit 1998.²⁸ Lahi Brahimaj u bë drejtor i degës së financave në korrik 1998.²⁰

Për keqardhje, këto dëshmi të rrejshme duhet të jenë si rrjedhojë e një dëshire për propagandim sa më glorifikues, që vetë këta dëshmitarë e kanë parapëlqyer, që të prezantohen si protagonistë sa më shkëlqyes! Më fisnike do të ishte sikur të përgjigjeshin “nuk e di” (në pyetjen përkatëse), se sa të dëmonin rrejshëm. Uroj të mos kenë dëshmuar nën betim...

Me gjasë edhe Kryeprokurori Smith, në aktakuzën që ka ngrit kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve, është bazuar në atë gjykim, për ta prezantuar gabimisht një segment historik të Shtabit të Përgjithshëm (SHP) të UÇK-së. Po e citoj pikën 15 të aktakuzës:

Në fund të vitit 1993, LPK-ja krijoi një sektor të posaçëm për bashkërendimin e veprimtarive të njësiteve të armatosura në Kosovë. Në vitin 1994, LPK-ja tashmë përdorte emrin UÇK për organizatën në kuadër të së cilës po bashkoheshin grupet e armatosura në Kosovë. U krijua një Shtab Qendror ose i Përgjithshëm (që më lart përkufizohen bashkërisht si ‘Shtabi i Përgjithshëm’) në të cilin bënë pjesë Azem SYLA, Xhavit HALITI, Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI, Lahi BRAHIMAJ dhe Sokol BASHOTA. Në vitin 1997 Shtabit të Përgjithshëm i ishte bashkuar edhe Jakup KRASNIQI. Hashim THAÇI dhe Kadri VESELI merreshin, ndër të tjera, me organizimin e UÇK-së, duke përfshirë edhe mbajtjen e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë dhe atyre që ishin të vendosur gjetkë. Rexhep SELIMI e kishte bazën në Kosovë dhe, bashkë me të tjerë, forcoi dhe bashkërendoi veprimet e armatosura në terren. Sikurse u

²⁰ Bislim Zyrapi, Prova materiale P160, para. 16; Bislim Zyrapi, Prova materiale P159 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 3212-3213, 3394; Bislim Zyrapi, T. 759-760; Jakup Krasniqi, Prova materiale P64 (transkripti origjinal *Haradinaj*), T. 5075.

përshkrua më lart, që të gjithë, Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI, vazhduan të mbanin poste të larta në UÇK dhe/ose QPK gjatë periudhës që lidhet me këtë aktakuzë.²¹

Në vazhdim po paraqes në versionin telegrafik historinë e UÇK-së, me shpresë se do t'i bind hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët, që të mos bëjnë formulime duke u bazuar në informata e dëshmi propagandiste dhe dezinformuese. Nga kjo paraqitje do rezultojnë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi deri në vitin 1998 nuk ishin anëtarë as në Shtabin Qëndror (17.11.1994 – 27.01.1997), as në Shtabin e Përgjithshëm (formuar gjatë muajve maj-qershor të vitit 1998, por data e formimit vazhdon me qenë diskutabile). Bile nuk ishin as pjesëtarë të UÇK-së. Lah Brahimaj nuk duhet të ketë qenë anëtar në Shtabin Qëndror, edhe pse ka bashkëvepruar me Rexhep Selimn. “Koordinator” i Shtabit Qëndror ishte Nait Hasani (i burgosur më 27 janar 1997 dhe i dënua Gjykatës serbe në Prishtinë më 20 vjet burg (Aktgjykim, nr. prot. 68/97, i datës 12 dhjetor 1997).²² Anëtar i Shtabit Qendror ishte edhe Xheladin Gashi, ndoshta edhe Bislim Zogaj (i burgosur me 31 janar 1997, i dënua në “grup” me Nait Hasanin.)

UÇK-ja, e mitizuar sidomos nga 28 Nëntori 1997, për shkak të spektaklit në varrimin e mësuesit Halit Geci, në Llaushë të Skenderajit,²³ është formuar me vendim të Mbledhjes së Katërt të përgjithshme (M4P), të mbajtur më 26 dhe 27 korrik 1993, në Prishtinë (në shtëpi-

²¹ Aktakuzë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, nr. KSC -BC -2020-06, e datës 4 nëntor 2020, kundër të pandurve: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Në këtë dëshmi do e citoj këtë variant zyrtarë të shqipërimit, meqë nuk e zotëroj anglishte për ta përdor versionin origjinal.

²² <https://www.mekulipress.com/ne-emer-te-popullit-aktygikimi-i-viti-1997-sa-vjet-u-denua-nait-hasani-sa-vjet-dhe-si-u-denua-qerim-kelmendi-tashme-i-ndjere-kush-ishin-gjykatesit-qe-denuan-18-shqiptaret-qe-kane-formuar/>

²³ <https://www.koha.net/arberi/60040/20-vjet-nga-dalja-publike-e-ucq-se/>

në e prindërve të Fatmir Brajshorit).²⁴ Mbledhja është mbajtur në klandestinitet të thellë. Megjithatë, pas dy ditëve, shërbimi serb, RDB, i ka burgosur shumë pjesëmarrës të kësaj mbledhjeje. Sigurisht, ata dikush duhet t'i ketë spiunuar. Ato burgosje kanë pamundësuar të nis menjëherë realizimi i vendimit për formimin e krahut të armatosur çlirimtar, të cilin Lëvizja e vlerësoi si domosdoshmëri jetike, sepse “krahu pacifist” (LDK dhe partitë tjera “legale”)²⁵ tashmë po vegjetonte si kënetë kundërmuese, me bretkoca – që zhurmonin vetëm aq sa i toleronte regjimi pushtues, nacionalist-fashistoid i presidentit serb Slobodan Millosheviq.

Në dhjetor 1993 arratisen nga Kosova në Shqipëri edhe Hashim Thaçi dhe Fatmir Brajshori.

Më 4 dhjetor 1993, bazuar në obligimet statutare, Këshilli i Përgjithshëm (KP) i Lëvizjes në emigracion, vendos jetësimin e vendimit të M4P. Me atë rast, KP ka themeluar Sektorin e rëndësisë së vëçantë (SRV). Kështu e kemi quajtur ekipin që do të angazhohej për ta ndihmuar Lëvizjen në Kosovë - që ta realizonte formimin e krahut të armatosur çlirimtar të saj (të cilin po e quaj ushtri për hir të komunikimit më praktik, edhe pse ende nuk ishte ushtri). Sektorin e kemi quajtur SRV për arsye konspirative. E kemi autorizuar Kryesinë t'i caktojë tre veta në SRV. Njëkohësisht kemi formuar edhe Fondin VTH, për grumbullimin e mjeteve financiare për ushtrinë në formim.

²⁴ Pjesëmarrës: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Adnan Asllani, Isa Krasniqi, Xheladin Gashi, Hashim Thaçi, Fatmir Brajshori, Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Beqir Beqa, Sabri Kiçmari, e të tjerë.

²⁵ Partitë e formuara në Kosovë gjatë vitit 1990 quheshin legale vetëm pse u rregjistruan në intitucionin përkatës në Beogradin pushtues, dhe tashmë Beogradi i kontrollonte e komandonte më efektivisht se sa e komandonte Lidhjen Komuniste të Kosovës, sidomos gjatë viteve 1974-1989, kur Kosoava e kishte autonominë kushtetuese, federative, si Krahinë Autonome Socialiste (KSA).

Si fillim, jemi përcaktuar që secili anëtar i Lëvizjes t'i jepë nga 1000 DM në vit, përveç 50 DM të anëtarësisë mujore.

Në fundjavën pasuese, më 11.12.1993, Kryesia i ka caktuar Ali Ahmetin, Xhavit Halitin dhe Azem Sylën në SRV.

Fatkeqësisht, qysh në fillim të angazhimit të SRV është përvijuar angazhimi komplotis kundër ngritjes dhe konsolidimit të krahut të armatosur çlirimtar. Azem Syla dhe Xhavit Halit, që deri atëherë nuk ishin fare kompatibël e nuk kishin shoqëri mes tyre, u bënë aleatë. Azemi ka rekrutuar në Kosovë Rexhep Selimin, Xheladin Gashin dhe Sokol Bashotën. Xhavit Haliti ka rekrutuar Nait Hasanin. Ali Ahmeti, ndërkaq, i anashkalluar nga Xhavit dhe Azemi, ka vazhduar të përkujdesej për grupet guerile të Adem Jasharit, Zahir Pajazitit, Adrian Krasniqi, dhe të tjera grupe më të vogla, të cilat ishin formuar para M4P dhe tani po prisnin të përfshiheshin në ushtrinë në formim.

Më 17 nëntor 1994 Kryesia e Lëvizjes përcaktohet për emrin **Ushtra Çlirimtare e Kosovës (UÇK)**²⁶. Në të njëjten mbledhje, Kryesia përcaktohet për "Shtab qendror", pa i ditur emrat, por duke u bazuar në mirëbesim ndaj SRV (kryesisht të Xhavit Halitit dhe Azem Sylës). Gjithashtu, Kryesia në të njëjten mbledhje vendosi të publikonte komunikata për aksionet që kryente UÇK-ja në formim, në Kosovë, duke filluar nga komunikata me numrin 11, për të lënë të nënkuptohet se aksionet e deriatëhershme guerile ishin publikuar në 10 komunikatat pararendëse, të cilat, në fakt, nuk ishin publikuar.²⁷ Pra, meqë UÇK-ja nuk i kishte ende kapacitetet në Kosovë për t'i publikuar vet komunikatat, Kryesia e Lëvizjes (në emigracion) u

²⁶ Kësaj radhe kishte të drejtë statutare të ushtronte kompetencën si Kryesi e gjithë Lëvizjes (edhe asaj në Kosovë), meqë udhëheqja e Lëvizjes kishte humb funksionalitetin për shkak të burgosjeve që ndodhen pas M4P.

²⁷

<https://www.facebook.com/photo?fbid=745674199366596&set=a.1767908195882>

përcaktua t'i shkruante e t'i publikonte, "në emër" të SHQ të UÇK-së. Komunikatat në vazhdim, deri ajo me numër 49, i ka shkruar e publikuar Kryesia (sepse SRV i kishte tre veta qe nuk dinin të formulonin komunikata). Pastaj, nga komunikata nr. 50 e tutje, janë formuluar nga NPK-ja (Xhavit Haliti, Azem Syla, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi) dhe argatët e tyre.

Nga investigimet që i kam bërë gjatë viteve të pasluftës, më rezultoi se SHQ (Shtabi Qendror), deri më 27 janar 1997, kur ishte burgosur Nait Hasani, përbehej vetëm nga Nait Hasani, Rexhep Selimi, Xheladin Gashi dhe Sokol Bashota. Spekullohet se edhe Bislim Zogaj, i burgosur më 31 janar 1997, ishte anëtar. Ndërsa, komandantë të asaj katërsheje janë vetëquajtur Xhavit Halit dhe Azem Syla. Ai SHQ mund të ketë pas, gjithsej, 5-6 ushtarë, meqë pjesëtarët e grupeve guerile, - për arsyt që nuk kam mund t'i identifikoj, - nuk kanë pranuar të subordinohen në komandimin e atij SHQ. Besoj, pengesa kryesore duhet të ketë qenë Xhavit Haliti, meqë për të, qysh moti, kishim dyshuar se ishte marionetë e shërbimeve jugosllave.

Pra, ai SHQ, gjegjësisht "komandantët" e tij, Azem Syla e Xhavit Haliti, nuk i quante pjesëtarë të "uçk" se tyre Adem Jasharin, Zahir Pajazitin dhe Adrian Krasniqin, me grupet e tyre, as edhe grupet e tjera guerile. Që do të thotë, ata ishin UÇK-ja, kurse SHQ i Xhavit Halitit dhe Azeme Sylës ishin simulimi "uçk" për ta përdor kundër UÇK-së.

As sipas aktgjykimit të Nait Hasanit dhe 17 të tjerëve, nuk rezultoi se ai SHQ dhe ushtarët e tij kanë bërë ndonjë sulm gueril gjatë katër viteve (Kishin planifikuar, por kishin dështuar në finalizim të tyre...).

Ndihmat financiare, të grumbulluara në Fondin VTH, nga dhjetori 1993 deri në mars 1998, i ka zhvatur kryesisht Xhavit Haliti. Një pjesë simbolike e tyre iu kanë shkuar Nait Hasanit, Rexhep Selimit e

Sokol Bashotës, sa për të na mashtruar se po e financonin UÇK-në, ndërsa grupet guerile, që vërtet ishin berthama të UÇK-së, janë privuar nga ato ndihma financiare. Këtë sabotazhë e kemi kuptuar qysh në verë të vitit 1996, kur komandantë të grupeve guerile kanë kërkuar ndihma financiare te familjarët dhe shokët e tyre, në emigracion, sidomos nga ata që ishin angazhuar në Lëvizje, Nëndega në Gjermani.

Pas burgosjes së Nait Hasanit dhe Bislim Zogajt, ai SHQ e ka humbur edhe funksionalitetin e deriatëhershëm.

Pra, shpërthimi kryengritës, pas barbarisë së forcave serbe ndaj familjes së Jasharëve në Prekaz, më 5-7 mars 1998, na ka gjetur pa asnjë shtab, pos atij fiktivit, që e simulonin Xhavit Haliti dhe Azem Sylja, për t'i zhvatur ndihmat financiare që grumbullonim e jepnim për UÇK-në.

2.2. Meqë nuk kishim shtab, që do të koordinonte e komandonte shpërthimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, Kryesia e Lëvizjes (e emigracionit) u shpërngul nga Perëndimi në Tiranë, për të improvizuar shtabin. Kryetar i Kryesisë ishte Fazli Velia, nënkryetar Muhamet Kelmendi, sekretar Emrush Xhemajli, arkëtar Gafurr Elshani. Ali Ahmeti, Xhavit Haliti, Azem Sylja e Rexhë Iberdemaj ishin anëtarë.

Kryesia praktikisht në mars 1998 e zhbëri SRV-në. Ajo Kryesi improvizoi rolin e shtabit deri nga mesi i prillit 1998.

Financat e Fondit vazhdonte t'i grabiste Xhavit Haliti, i cili ia kishte dalë t'i mashtronte e t'i shpërdoronte kryetarin e Këshillit të Fondit, Jashar Salihun, dhe disa veprimtarë kryesorë të Fondit.

Nga mesi i prillit 1998, kur Kryesia provoi t'i dicitlinonte Xhavitin dhe Azemin, që t'u përmbaheshin vendimeve, Xhavit i kërcënoi kolegët dhe shokët e tij të deriatëhershëm që të iknin nga Shqipëria.

Isha i parnishëm kur e bëri atë kërcënim. Ai shpërdoroi lidhjet e tij me kryeministrin kuisling të Shqipërisë, bixhozgjijun e inkriminuar Fatos Nano...

Nga ajo Kryesi unë isha ngarkuar me detyrën e përkujdesjes për oficerët e ish Ushtrisë jugosllave, JNA, që ishin dëshmuar në luftërat në Slloveni, Bosnjë, Kroaci, dhe që tani donin të inkuadroheshin në UÇK. Ata, në mungesë të shtabit, prisnin në Tiranë dhe askush nuk ua tregonim të vërtetën – se UÇK-ja nuk kishte shtab që të vendoste për sistemim të ushtarakëve që prisnin, për hir të diciplinës ushtarake.

Por nga mesi i prillit 1998 edhe ata e kuptuan se nuk kishte shtab, prandaj u futen në Kosovë, në mënyrat që i gjeten më të përshtatshme, dhe iu bashkuan UÇK-së, kryesisht në krahinat ku e kishin vendlindjen.

Ata ushtarakë filluan t'i rreshtonin kryengritësit për t'i bërë ushtarë, që pranorin të komandoheshin, duke krijuar, kështu, edhe zanafillën e Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë, bashkë me komandantët e zonave, që përpiqeshin ta koordinonin e komandonin luftën, në kuadër të kapaciteteve modeste ushtarake që i kishin. Ndër 'ta u shqua dhe u faktorizua, ekstra, koloneli Bislim Zyrapi, i cili, në mesin e majit 1998, i është bashkuar UÇK-së.

2.3. Xhavit Haliti dhe Azem Sylja, pasi i dëbuan anëtarët e tjerë të Kryesisë, u përqëndruan në zhbërjen e Sektorit të logjistikës në Shqipëri, të cilin e kishin formuar, që nga viti 1992, vëllezërit Adrian e Ilir Krasniqi, Qerim Kelmendi dhe bashkëluftetarët e tyre.

Pas vrasjes së Zahir Pajazitit, më 31 janar 1997, Zona Operative e Llapit e dërgon Ilir Konushevcin / "Mërgimi" në Shqipëri, për të organizuar furnizimin e UÇK-së me armë e municion.

Iliri, bashkë me Qerim Kelmendin / “Dema” dhe Naim Hazirin / “Dilaveri”, tashmë, po e menaxhonin Sektorin logjistik në Shqipëri. Kërcënimet ndaj tyre, Xhaviti dhe Azemi i konkretizuan dhe i vulgarizuan, nga fundi i marsit 1998, sidomos kundër Qerimit dhe Ilirit.

Për t’iu shmangur vrasjeve mes pjesëtarëve të UÇK-së dhe komplotistëve të NPK-së, Iliri e Qerimi u dakorduan që Qerimi të emigronte në Gjermani, me arsyetimin taktik, se Qerimi do ta vazhdonte mjekimin e plagëve të marra në sulmin e policisë serbe, në vitin 1996, (shih Akgjykimin e Nait Hasani dhe 17 të tjerëve, i sipërcituar) dhe se, njëkohësisht, do të angazhohej edhe në motivimin e mërgimtarëve tanë për ta ndihmuar më shumë financërisht UÇK-në.

Pas emigrimit të Qerimit, Iliri bën sikur ishte i gatshëm për bashkëpunim me Xhavitin e Azemin dhe, për t’iu shmangur përplasjeve me ‘ta, subordinohet nën komandën e tyre. Megjithëkëtë, këta të fundit nuk mjaftohen me kaq. Për ta zhbërë Sektorin e logjistikës, Xhaviti e Azemi, si komplotistë të rryer, duhet ta kenë bërë planin për eliminimin fizik të Ilirit, për çka duhet të kenë marrë OK nga eprorët e tyre.

Për bindjen time të deritanishme, Xhaviti dhe Azemi e kanë paguar kriminelin Bislim Demiri, që ishte i afirmuar në Tropojë (në Veri të Shqipërisë) për vrasje me pagesë. Krimineli Demiri ishte shofer i shefit të Policisë, Jonuz Hyka, në Bajram Curr. Bislimi, bashkë me vëllain e tij, Agimin, dhe dy-tre shokë, siç kanë rrëfyer njerëz mirë të informuar, më 9 maj 1998, në Qafë të Malit, në rrugën Fushë Arrëz - Bajram Curr, i kanë zënë pritë Ilirit, cili po dërgonte sasi të madhe të armëve dhe municionit në Tropojë, prej ku do të futeshin ilegalisht në Kosovë. Ilirin e kanë shoqërouar mjeku tropojan Hazir Mala, një

oficer i SHISH-it dhe dy ushtarakë të Gardës së Shqipërisë, siç ka rrëfyer para pak kohe i mirëinformuari Xhavit Haliti.²⁸

Në shkëmbim të shtënave me armë, rreth orës dy të mëngjesit, vriten Iliri dhe mjeku Hazir Mala, ndërsa vrasësi Agim Demiri plagoset dhe vdes gjatë rrugës drejt spitalit të Bajram Currit. Fatos Nano, duke shpërdoruar funksionin e kryeministrit, ka urdhëruar të mos zhvilloheshin hetimi për ato vrasje. Këtë ma ka thanë ish-kryprokurori i Shqipërisë, Theodhori Sollaku, në prani edhe të një funksionari të lartë shtetëror.

Pas vrasjes së Ilirit, Sektorin e logjistikës e ka menaxhuar Gani Nuha, nga Jezerci i Ferizajit, me banim në Dysseldorf.

2.4. Formimi i (pseudo) Shtabit të Përgjithshëm.

Në fund të marsit apo në fillim të prillit 1998, Hashim Thaçi u shfaq në Tiranë, i shoqëruar nga Kadri Veseli. Atëherë më patën lutur t'iu ndihmoja që të merreshin vesh me vëllain tim, Qerimin. Për këtë qëllim u takuam në hotelin Tirana, në Tiranë. Hashimi e filloi bisedën me kërkesën ultimatve, që Qerimi t'i subordinohej komandës së tij. Qerimi këmbëngulës, kërkonte informim e dëshmi konkrete, që Hashim Thaçi kishte ndonjë përgjegjësi në UÇK. Kështu, pas një grindjeje mes tyre, ata u ndanë pa mirëkuptim e pa marrëveshje.

Qerimi ishte ushtari i parë i UÇK-së, i plagosur në një sulm gueril ndaj policisë serbe, në Fashatin Qollapek të Pejsë, në verë të vitit

²⁸ https://www.youtube.com/watch?v=M_uMaEGPaMc

1996. Për këtë arsye ishte dënuar, në mungesë, me 15 vjet burg, më 12 dhjetor 1997.²⁹

Kadriun e njihja nga viti 1992. Ma kishte prezantuar vëllai im, Qerimi, meqë ishin shokë në studime dhe bashkëpunëtorë në Lëvizjen klandestine, në Univesitetin e Kosovës, në Prishtinë.

Hashimin e kam takuar për herë të parë në Zvicër, në një mbledhje të KP-së të Lëvizjes në vitin 1994.

Më vonë, konkretisht gjatë Konferencës së Rambujesë, në muajin shkurt 1999, u binda se Hashim Thaçi ishte marionetë e DGSE-së franceze (Direction Générale de la Sécurité Extérieure), e cila atëherë më serbofile sesa simotra e saj, RDB-ja serbe; Hashimi e prezantonte eprorin e tij, francezin Arnaud DANJEAN³⁰ si shok të tij, që ta kamuflonte marionetizimin e tij ndaj DGSE-së. Serbofili Danjean, ishte shef në DGSE, drejtoria për Ballaknin. Ai e komandonte personalisht Hashimin. Kjo dëshmon për rëndësinë e kompleteve që duheshin realizuar përmes Hashimit. Z. Danjean tashmë është parlamentar në Palamentin e BE-së.³¹ Edhe në një takim “rasti” me Presidentit Macron, më 14 mars 2018 në Paris, kur qe organizuar prezantimi i një libri propagandist për Hashimin, në tavolinë ishte i pranishëm edhe “shoku” Arnaud Danjean.³² [Avokatët e Hashimit do t’i këshilloja që Z. Arnaud Danjean ta propozojnë si dëshmitar që të dëshmon se gjatë gjithë e pas lufte e ka komanduar Hashimin;

²⁹ <https://www.mekulipress.com/ne-emer-te-popullit-aktygikimi-i-viti-1997-sa-vjet-u-denua-nait-hasani-sa-vjet-dhe-si-u-denua-qerim-kelmendi-tashme-i-ndjere-kush-ishin-gjykatesit-qe-denuan-18-shqiptaret-qe-kane-formuar/>

³⁰ https://fr.wikipedia.org/wiki/Arnaud_Danjean

³¹ https://www.europarl.europa.eu/meps/en/96747/ARNAUD_DANJEAN/main-activities/reports-shadow

³² Arnaud Danjean shihet iulur në në krahun e djathët të Presidentit Macron (më 14 mars 2018) - por në cilën cilësi, si „shok“ i Hashim Thaçit, apo si këshilltar i Presidentit Macron për çështje të Kosovës(?!); <https://twitter.com/HashimThaciRKS/status/973902969023365125/photo/4>

rëndon, marioteta nuk mund të fajsohet për atë që bën, sepse nuk ka autonomi...]

Po ky Hashim, erdhi si përforcim i Xhavitit dhe Azemit, në fund të marsit apo në fillim të prillit 1998. Dyshoj së RDB-ja e Serbisë ia kishte "shitur" Hashimin DGSE-së franceze, ashtu siç ia shet lojtarin e vet një klub i futbollit, klubit tjetër. Ndryshe, ku dhe si do ta gjente z. Arnaud Danjean Hashimin, për ta rekrutuar?!

Deri në qershor 1998, UÇK-ja në Kosovë ishte vetorganizuar, duke kaluar shifrën e 10 mijë pjesëtarëve të saj, pa ndihmë të asnjë shtabi qëndror apo të përgjithshëm dhe përkundër plaçkitjes së shumicëns së ndihmave financiare nga Xhaviti me bashkëkomplotistët e NPK-së dhe sabotimit me furnizim me armë, municion, e gjësende tjera që i duhen një ushtrie.

Në këtë kohë Hashimin duhet ta kenë urdhëruar DGSE-ja që të simulonte sikur e kishte formuar vetë Hashimi Shtabin e Përgjithshëm, tashmë i formuar nga koloneli Bislum Zyrapi me kolegët e tij, në koordinim me komandantët e zonave. Këtë lloj të manovrimit komplotist Hashimi duhet ta ketë bërë më 10 apo më 11 qershor të vitit 1998.

Komisioni qeveritar për njohjen e statusit të veteranëve pat publikuar Listën vijuese të personave që paskëshin qenë anëtarë të Shatbit të Përgjithshëm (përbërja e ngushtë, meqë ekziston edhe lista me rreth 300 emra të Shtabit të Përgjithshëm, përbërja gjithëpërfshirëse):

- 1. Adem A. Grabovci 063042 Saradran VETERAN*
- 2. Adem Z. Demaçi 047401 Prishtinë VETERAN*
- 3. Agim H. Çeku 000002 Qyshk VETERAN*
- 4. Ali I. Ahmeti 057538 Zajaz VETERAN*
- 5. Alush S. Agushi 064628 Drenoc VETERAN*
- 6. Avdi H. Raci 00004 Siqevë VETERAN*

7. Azem R. Syla 000007 Kishnarekë VETERAN
8. Berat S. Luzha 045873 Begracë VETERAN
9. Bislim S. Zyrapu 042992 Studençan VETERAN
10. Fatmir K. Limaj 014976 Banjë VETERAN
11. Fatosh Q. Klosi 039569 Tiranë VETERAN
12. Hashim H. Thaqi 000001 Burojë VETERAN
13. Isni B. Thaqi 055439 Burojë VETERAN
14. Jakup J. Krasniqi 000478 Negroc VETERAN
15. Kadri F. Veseli 064383 Mitrovicë VETERAN
16. Lahi Sh. Brahimaj 000003 Jabllanicë VETERAN
17. Musa H. Jashari 006952 Prekaz INVALID
18. Naim R Maloku 003095 Llabjan INVALID
19. Nait Xh. Hasani 000475 Randobravë VETERAN
20. Nuri I. Bexheti 016257 Tetovë VETERAN
21. Ramë G. Buja 045994 Bujan VETERAN
22. Rexhep D. Selimi Aqarevë VETERAN
23. Sabit L. Brokaj 032393 Brataj VETERAN
24. Sabit Sh. Geci 004153 Llaushë INVALID
25. Sali Sh. Veseli 041623 Smolicë VETERAN
26. Shaip H. Muja 016162 Gradicë VETERAN
27. Sokol M. Bashota 014814 Caravik VETERAN
28. Sokol Q. Dobruna 059504 Gjakovë VETERAN
29. Sylejman Selimi 014588 Aqarevë VETERAN
30. Xhavit I Ferizi 000014 Plluzhinë VETERAN
31. Xhavit M. Haliti 057611 Novosellë VETERAN
32. Xheladin H. Gashi 050416 Komoran VETERAN³³

33

https://www.komveterani.net/repository/docs/VETERAN_DHE_INVALID_shp_kom_anda_0805.pdf?fbclid=IwAR2eV1y41jTMD0BvKw6sC4KqTKLf1dPPIdxfM4ZzQUzqKB1k1d6Nqn9N05Q

E paskan mbyll para 4-5 ditësh, ndoshta nga frika se ZPS-ja do e përdor si dëshmi, apo ua kanë prishur hakerët?

Në këtë listë, emri i Adem Demaçit figuron vetëm për qëllime propagandistike, sepse ai nuk ka qenë anëtar i SHP, as ka qenë pjesë e mbledhjeve dhe vendimeve të tij. Ali Ahmeti, po kështu, nuk ka qenë kurrë anëtar i SHP-së, respektivisht nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje, as ka qenë pjesë e ndonjë vendimi të SHP-së.

Vetëkuptohet që as Fatosh Q. Klosi, gjegjësisht Fatos Klosi, siç e njohim me emër publik njeriun që gjatë viteve 1997-2002 ishte kryeshef i Shërbimit Informativ Shtetëror të Republikës së Shqipërisë (SHISH), nuk ka qenë anëtarë i SHP-së. Ai ka merita të shumta për hapjen e rrugës atyre që merreshin me furnizimin e UÇK-së me armë e municion dhe futjen klandestine në Kosovë, por nuk ishte anëtar i SHP-së. Nait Hasani ishte në burg nga 27 janari 1997 e deri sa është zhbërë edhe SHP i UÇK-së. Ai, prandaj, nuk ka pas mundësi fizike të ishte anëtar, pos nëse ka pas edhe anëtarësi të improvizuar me korrespondencë apo anëtarësi nderi. Prof. Dr. Sabi Brokaj, tashmë i ndjerë, ishte funksionar në Qeverinë e Shqipërisë. Ai edhe publikisht ka shprehur habi për dhënien e statusit të veteranit, si anëtar i SHP të UÇK-së, duke sqaruar se nuk ka qenë anëtar i atij shtabi.³⁴ Është vepër inkriminuese, prandaj, shpërdorimi i Komisionit qevritar, për njohje të statusit të veteranëve edhe për ata që fare nuk kanë qenë anëtarë të SHP!

Njëri nga anëtarët e SHP-së, oficer karriere, në komunikim privat më ka shkruar:

Në mars 1999, anëtarë të SHP-së ishim:

1. *Sylejman Selimi (komandant SHP),*
2. *Agim Çeku (komandant SHP),*
3. *Bislim Zyrap (Shef i SHP),*
4. *Kadri Veseli (Shef i Zbulimit),*
5. *Hashim Thaçi (Drejtor i Drejtorisë politike),*

³⁴ <https://sot.com.al/politike/fatos-klosi-dhe-sabit-brokaj-n%C3%AB-list%C3%ABn-e-veteran%C3%ABve-t%C3%AB-u%C3%A7k-pag%C3%AB-mujore-nga-kosova>

6. *Jakup Krasniqi (Zëdhënës),*
7. *Azem Syla (komandant i SHP),*
8. *Ramë Buja (anëtar i SHP)*
9. *Sali Veseli (Shef Operativ në SHP),*
10. *Sokol Dobruna (Drejtor i Drejtorisë Juridike),*
11. *Rexhep Selimi (Inspektor i SHP),*
12. *Fatmir Limaj (Shef i Policisë Ushtarake),*
13. *Dilaver Goxhaj (anëtar i SHP),*
14. *Idris Hyseni (Shef i Logjistikës),*
15. *Adem Grabovci (Shef i Financave),*
16. *Bardhyl Tahiri (Shef i Xhenos),*
17. *Syla nga Reçaku (Shef i Ndërlidhjes),*
18. *Mensur Kasumi (Shef i Kundërzbulimit).*
19. *Ekrem Rexha (anëtar SHP),*
20. *Lum Haxhia (nga fundi i mars 1999 zëdhënës i SHP)*
21. *Durak Zyrapi (Shef i Shëndetësisë).*
22. *Mustafë Gashi (protokolist dhe shef i Arkivit),*
23. *Ahmet Qeriqi (Drejtor i Radios „Kosova e lirë“),*
24. *Berat Luzha (Drejtor i Agjencisë Kosovapress).*

2.4.1. Sylejman Selimi, Komandanti i parë i SHP-së

Sylejman Selimi ka qenë komandanti i parë i Shtabit të Përgjithshëm (SHP), emrin e të cilit SHP e ka bërë publik. Ai është zgjedh nga komandantët e zonave dhe ndonjë komandant tjetër, më 6 shkurt 1999. Pra, pak orë para fillimit të Konferencës së Rambujesë është publikuar emri i tij si Komandant i SHP. Ata (komandantët që e kanë zgjedh Sylejmanin) kanë gjykuar që emri i komandantit të SHP të UÇK-së duhej të publikohej para fillimit të Konferencës së Rambujesë, që UÇK-ja të ketë më shumë legjitimitet, duke i publikuar emrat real të komandantëve, e jo si deri atëherë me “gjarpni”, “zeka”, “dhetshi”, “daja”...

Pjesë e atij SHP të UÇK-së, ata të NPK-ja, e kishte selinë në Tiranë. Tre nga ata i ishin imponuar Delagcionit në Rambuje (Hashimi,

Xhaviti, Azemi), sepse ata i favorizonin diplomatët operativ që ishin përcaktuar ta vikimizonin Kosovën në atë Konferencë.

Marionetat komplotiste, pjesëmarrëse në Konferencë të Rambujesë, sidomos pseudokomandanti Azem Sylja, e përjetuan rëndë zgjedhjen / caktimin e Sylejman Selimit për komandant të UÇK-së. Ata i ka pas përfshirë ankthi për të ardhmen e tyre, prandaj atë zgjedhje/caktim të Sylejman Selimit e diskualifikuan si puç ushtarak. Por Sylejman Selimi u zëvendësua vetëm kur në Kosovë hyri Gjeneral-majori Agim Çeku, më 17 prill 1999.

2.4.2. Gjeneral-koloneli Agim Çeku

Agim Çekun, në vitet para se të angazhohej në UÇK, ishte anëtar i Shtabit të Ushtrisë kroate. Në vitin 1996, pasi në kufirin austriako-sloven kufitarët slovenë na kthyen Fehmi Lladrovci dhe mua, që ishim në rrugëtim me auto për të takuar ushtarakët që i njihnim në Slloveni dhe Kroaci, Fehmiu thirri Agimin për të marrë pjesë në një takim konsultues me ushtarakët e strehuar si azilantë në shtete e Perëndimit. Takimi, ku merrnim pjesë rreth 25 veta (isha edhe unë), e pat organizuar ushtaraku Ramadan Gashi³⁵, i strehuar në Zvicër. Takimi që bërë në Cyrih, nëse e kam mbajtur mend tamam vendin e takimit. Z. Çeku pat ardhë i shoqëruar me dy badiguarda të Ushtrisë kroate. Në atë takim u diskutua për përgatitjen e ushtarakëve të karrierës, për të hyrë në Kosovë, si përforcim profesionist për UÇK-në, meqë parashikohej fillimi i luftës në Kosovë. Fehmi Lladrovci, Agim Çekut dhe shumica e pjesëmarrësve në atë takim, u patën pajtuar për fillimin e përgatitjeve të ushtarakëve, për të hyrë në Kosovë. Agim Mehmeti, ndërkaq, këmbëngulte, siç thoshte vetë, në “institucionalizime legale”. Sipas tij, nuk mund të kishte ushtri pa e formuar e komanduar „presidenti“ Ibrahim Rugova. Debatimi ndërmjet kolonelit Mehmetit dhe gjeneralit Çeku, në Takimin e Cyrihut, që shumë i ashpër.

³⁵ <https://www.facebook.com/ramadan.gashi.332>

(Koloneli Agim Mehmeti, tashmë i ndjerë, më 7 mars 1997 është „caktuar“ zëvendës i kolonelit Ahmet Krasniqi. Ai ka folur në tubime të ndryshme dhe ka botuar edhe libër për formimin dhe komandimin e FARK-ut...) ³⁶

Z. Çeku qysh atëherë na pat thënë se, sipas rregullave në Kroaci, një anëtar i Shtabit të Ushtrisë së Kroacisë, dy vjet i nënshtrohet procedurës për t'u liruar plotësisht nga Ushtria kroate. pas momentit të miratimit të kërkesës së tij për lirim. Kështu, i bie që në fillim të prillit 1999, shteti kroat e ka liruar gjeneralin Çeku nga përgjesishtë komanduese në Ushtrinë kroate.

Çeku ka hyrë në Kosovë më 17 prill 1999. Pseudo kryeministri Thaçi e ka emëruar komandant të SHP-së gjeneralin Çeku, ndërkaq, vetveten Thaçi, me atë rast, duhet ta ketë emëruar komandant të përgjithshëm të UÇK-së. Vendimet përkatëse duhet të jenë në ndonjë dosje të fshehur ose të konfiskuar nga KFOR-i apo UNMIK-u.

2.4.3. Koloneli Bislim Zyrapi

Kolonelin Zyrapi e pata cituar më lart, për dëshmi të rreme, e cila është „zyrtarizuar“ në Aktgjykimin e Ramush Haradinajt të Gjykatës „Ndërkombëtare“, në Hagë, më 29.11.2012. Edhe njëherë uroj të mos e ketë bërë dëshminë nën betim, meqë dëshmitë e rreme, nën betim, janë vepër penale.

Koloneli Bislim Zyrapi duhet të ketë hy në Kosovë rreth mesit të majit 1998. Nga 9 marsi 1998 deri kur ka hyrë në Kosovë, ai ka qëndruan në Tiranë, si edhe ushtarakët e tjerë, në pritje të sistemimit nga shtabi (inekzistent) i UÇK-së. Në fakt, Xhavit Haliti dhe Azem Syla e sabotonin hyrjen e oficerëve në Kosovë, sepse trembeshin që do ua „grabisin“ UÇK-në.

³⁶ Agim Mehmeti, LIBRI:“E VËRTETA PËR FARK-un“ (2014)

<http://floripress.blogspot.com/2014/02/librie-verteta-per-fark-un-nga-agim.html>

Agim Mehmeti, „E vërteta për FARK-un“, fjalim:

<https://www.youtube.com/watch?v=l7g4wUkelUI>

Koloneli Zyrapi duhet ta ketë filluar grupimin e kuadrove, qysh kur ka hy në Kosovë, për ta bërë një shtab, që do ta koordinonte komandimin qëndror. E kam me të dëgjuar që „Drejtori“ Gjarpni/Hashim Thaçi/ e kishte rrahur kolonelin Zyrapi, në mënyrë që ky i fundit ta kuptonte se nuk ishte komandant edhe i Gjarpnit. Ishte e kundërta: „Drejtori“ Thaçi ishte kryekomandant, edhe i Kolonelit Zyrapi. [Për të mos e rrëfyer atë krim, Gjarpni duhet ta ketë angazhuar këshilltar në Presidencë Kolonelin Zyrapi, siç ka vepruar edhe me të tjerë, për t’i heshtur, si rasti me Gjergj Dedajn, tani ambasador i Kosovës në Makedoni.]

2.4.4. Kadri Veseli

Kadriu e kam njohur në fillim të vitit 1992, në Tiranë, përmes vëllait tim, Qerimit, tashmë i ndjerë (i vrarë barbarisht, më 27 shkurt 2020, afër shtëpisë, në vendlindje, në fashatin Llabjan të komunës së Pejës). Kadriu dhe Qerimi kanë qenë kolegë në Fakultetin e bujqësisë, në Prishtinë, por dhe bashkëveprimtarë në organizimin klandestin, në kuadër të Lëvizjes.

Kam dëgjuar spekulime se Kadriu ishte anëtarësuar në Lëvizje përmes kushëririt të tij, Sabitit, por nuk jam i sigurt. Është spekuluar gjithashtu se Kadriu duhet ta ketë anëtarësuar Hashim Thaçin në Lëvizje, por as për këtë nuk kam informatë konkrete (në ndërkohë është paraqitur edhe Isa Krasniqi, tani shef i Agjensisë për Statistikë, si garantues për fisnikërinë e Hashimit?³⁷); Di që, për shkak të rrezikshmërisë së madhe, Lëvizja në Kosovë kishte bazë organizuese celulat, kryesisht nga tre anëtarë, dhe se, secili anëtar, mund të anëtarësonte edhe dy anëtarë të tjerë, për të formuar celulë të re.

Nuk kam asnjë dyshim për ndonjë krim konkret të Kadri Veselit, as se ishte marionetë e ndonjë shërbimi armiqësor, edhe pse, pas luftës, duhet të ketë organizuar shkuarjen e ca pjesëtarëve të UÇK-

³⁷ <https://www.facebook.com/isa.krasniqi.94>

së, apo të TMK-së (nuk më kujtohet koha as numri i saktë), në një kurs dresues të DGSE-së, në Francë.

Nuk kam mundur të konkretizoj infomacion të saktë, se kur duhet ta ketë sajuar Kadriu „Drejtorinë e Zbulimit“, në kuadër të SHP-së, as se kush e kur e ka caktuar Kadriun „Drejtor“ të atij shërbimi.

“Shërbimin Informativ të Kosovës“ apo „Kombëtar“ (SHIK-un), ndërkaq, pseudo kryeministri Hashim Thaçi duhet ta ketë formuar, me një vendim “kryeministror”, në fund të majit apo në fillim të qershorit 1999. Edhe ai vendim duhet të jetë në dosjen e pseu doqeverisë së përkohshme.

Për bindjen time, pjesëtarët e SHIK-ut ishin paramilitarë, gjegjësisht polici politike, siç thuhet për raste të ngjashme. Por, duke qenë Kadriu kryeshef i tij, unë, personalisht, jam ndjerë fizikisht më i sigurt. Madje vetë Kadriu, në prani të badigardave të tij, në verë 1999, pat thënë: “Ibrahim Kelmendit nuk do t’i hyjë as therrë në këmbë nga SHIK-u. E ka besën time“! Dhe i kam besuar e vazhdoj të kem konsideratë për të, përderisa nuk do t’i dëshmohen krime konkrete.

Uroj të lirohet Kadriu që të mbrohet në liri.

2.4.5. Hashim Thaçi

Siç shkrova më lart, në verë të vitit 1994, në mbledhje të KP-së të Lëvizjes, në Zvicër, e kam takuar e njohur, për herë të parë Hashim Thaçin. Dy vjet më herët, për Hashimin u informova nga shoku i tij, Fisnik Cuka, kryetar i Lidhjes së studentëve të Universitetit të Kosovës, tani me banim në Cyri / Zvicër)³⁸. Ai ishte ardhë për vizitë në Gjermani. E takova në Hamburg, në banesën e Muhamet Elshanit. Fisniku e lavdëroi ekstra Hashimin, duke e prezantuar edhe si prorektor-student (në atë kohë, pozitë e lartë udhëheqëse në

³⁸ <https://www.facebook.com/fisnik.cukaj>

Universitetin e Kosovës, që duhej të sigurohej me notat më të mira). Por Fisniku tregoi edhe se Hashimi dhe Genc Kelmendi (nipi i xhaxhait tim, tani mjek në Gjermani) ishin zënë fizikisht kur ishte përzgjedhë prorektori-student, sepse Genci, si student që i kishte nota më të larta, e pretendonte atë pozitë. Edhe Genc Kelmendi, kur erdhi në Gjermani, ma pat rrëfyer atë zenkë, duke shtuar se Hashim Thaçi e kishte falsifikuar certifikatën e notave dhe e kishte shpërdoruar organizimin klandestin të Lëvizjes, dhe, kështu, e kishte grabitur atë pozitë.

Në ndërkohë, sidomos nga bashkëveprimtarët emigrantë, që ishin nga ana e Drenicës, dëgjoja se Gani Thaçit, vëllai më i moshuar i Hashimit, e kishte një kafehane në Skenderaj, që ishte eksponuar si “qerdhe” e RDB-së serbe, për grumbullimin e informatave dhe për rekrutimin e spiunëve. Për këtë arsye, dyshimi se autoriteti i vëllait më të moshuar të tij, kishte ndikuar që edhe Hashimi të rektutohej nga RDB-ja serbe, më dukej shumë i logjikshëm.

Meqenëse Hashimi në atë kohë nuk ia doli të imponohej si autoritet në Lëvizje, nuk e takova më, deri në fund të marsit apo në fillim të prillit 1998.

Hashimin mund ta kem parë edhe gjatë M5P të Lëvizjes, në vitin 1995, në Zvicër, por nuk më kujtohet të kem komunikuar me të.

Dëshmova edhe më herët se në fund të marsit apo në fillim të prillit 1998, Hashimi dhe Kadriu i kam takuar në Tiranë, ku më lutën që t'i takoja me vëllain tim, Qerimin, i cili iu duhej, sepse ishte afirmuar e mitizuar si ushtari i parë i UÇK-së, i plaguar në sulme guerile kundër policisë së Serbisë (1996).

Herën tjetër, pas disa muajve, po në Tiranë, i kam takuar rastësisht Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Ramiz Lladrofcin. Më ftuan të pija një kafe, në një lokal në afërsi. Aty po i priste Sabit Geci, të cilin nuk e njihja, por kisha dëgjuar për të, prej bashkëvendasve të tij.

“Përse takoheni kaq publikisht me këtë kriminel?! Doni që qëllimisht ta komprometoni UÇK-në?!” , i pyeta Hashimin, Kadriun e Ramizin.

“Me njeh që po më akuzon për kriminel?”, ma ktheu Sabiti qetësisht.

“Të njoh vetëm sipas rrëfime të bashkëvendasve tu, por nëse nuk je kriminel, të kërkoj falje. Megjithëkëtë, meqë të ka dal nami për kriminel, ti vetë do të duhej t’u thoshe këtyre që të mos takoheshin në lokale kaq të eksponuara, në qendër të Tiranës...”, iu përgjigja Sabitit.

Takimi i radhës me Hashimin duhet të ketë qenë në maj 1999, kur ai ishte për “vizitë” në Gjermani. E kishim mysafir edhe në banesën tonë në Këln.

Bilall Sherifi më pat lutur t’ia blenim Hashimit një kostum. Shkuam në “Kaufhof” dhe i blemë dy kostume e disa gjëra të tjera dhe i paguam me kartë bankare të Fondit VTH, xhirollgarinë e të cilit e kishim në Sparkasse Bonn.³⁹

Pas takimit të Thaçit me ministrin e jashtëm gjerman, Z. Joschka Fischer, patëm organizuar edhe konferencë shtypi, në Bundespressehaus në Bonn. Para konferencës u morëm vesh që Hashimi të mos fliste fare në gjermanisht, meqë nuk dinte të thoshte qoftë vetëm një fjali, pa gabime. Përkthyes dhe konferencier caktuam Sabri Kiçmarin. Hashimin e bindëm që, nëse në shqip bën ndonjë gabim, gjatë përkthimit, Sabriu mund ta korrigjonte.

Kur Sabriu ia dha fjalën Thaçit, si “drejtor politik” i UÇK-së dhe si “kryeministër” i Kosovës, Thaçi e “harroi” marrëveshjen që ai duhej të fliste vetëm shqip dhe, si delirant që ishte, filloi belbëzimin e tij gjermanisht. Në konferencë kishte shumë gazetarë. Ishte për

³⁹ Fondi „Vendlindja thërret“ në Gjermani ishte i regjistruar në emër të OJQ-së Demokratische Verinigung der Albaner in Deutschland e.V., Zyra qendrore: Wesselstr. 8, D-53113 Bonn, Banka: Sparkasse Bonn, BLZ (IB) 380500 00, Konto-Nr.: 85 431, e regjistrua në Gjykatën / Amtsgericht Siegburg, VR 2088/95.

keqardhje, kur ata, të neveritur nga belbëzimet e Hashimit, ikën nga konferenca.

Takimi tjetër me Hashimin më ndodhi në qershor 1999.

Disa ditë para Samitit ndërkombëtar për Kosovën, mbajtur në Këln, nën patronatin e Kancelarit gjerman, Gerhard Schröder, Sabri Kiçmari më pat lutur t'ia rezervoja Hashimit qëndrimin në një hotel, për ditët sa do të zgjatte ai Samit. Shkova në "Maritim", hoteli më i madh në atë qytet. Kur ia tregova datat për rezervim, recepcionisti më tha se i tërë hoteli ishte rezervuar nga Kabineti i Kancelarit Schröder, për delegacionet e shteteve pjesëmarrëse në Samit. Krejt spontanisht i thash se edhe kryeministri shqiptar është i ftuar në samit dhe, kështu, e bëmë rezervimin. I siguruam edhe ID-Card, për hyrje në hotel, gjatë ditëve të samitit.

Kur Hashim Thaçi dhe Bilall Sherifi arriten në Aeroportin Këln/Bonn, policia kufitare gjermane na njoftoi se Hashimi e ka të ndaluar hyrjen në Gjermani. Na u dashtë të bënim disa telefonata për ndërhyrjen e Ministrisë së jashtme gjermane, në lejimin e hyrjes së Hashimit në Gjermani.

Sapo hymë në hotel dhe Hashimi e Bilalli u ngjiten në dhomat e rezervuara, në holin e hotelit, m'u drejtua një person, që nuk e njihja. Më përshëndeti dhe m'u prezentua gjermanisht, duke ma thënë mbiemrin. Kur i thash se nuk po e njihja, ai qeshi, duke me thënë se është shok i Hashimit, dhe u habit pse Hashimi nuk më kishte informuar për ardhjen e tij. Ma dha edhe kartëvizitën. Ishte Arnaud Danjean... (të cilin e prezantova edhe më herët). Menjëherë filluam të grindemi me francezin Danjean, për vardisjen e tij, si shef i DGSE-së franceze, e cila atëherë ishte pothuajse më serbofile se RDB-ja e Serbisë. Ajo grindje zgjati goxha, meqë Hashimi e Bilalli u vonuan derisa zbritën në holin e hotelit. E ndërpreme grindjen kur ata erdhën dhe na u bashkëngjiten në tavolinë. Hashimit nuk i pat ardhë mirë që më rastisi ta njihja konkretisht eprorin e tij, Z. Danjean.

Digresion:

Gjatë gjithë kohës, sa kishte zgjatur Konferenca e Rambujesë, nga 6 deri më 23 shkurt 1999, Z. Danjean, i kamufluar si “këshilltar” e si “shok”, i ka qëndruar mbi kokë Hashimit. Ai ka ndikuar në imponimin e Hashim Thaçit, si kryetar i Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë; ai ka komanduar që Hashimi të refuzonte nënshkrimin e „marrëveshjes“ – për ta barazuar, në faj, Delegacionin e Kosovës me Delegacionin e Serbisë; ai ka komanduar nënshkrimin e “marrëveshjes” me pseudo presidentin Ibrahim Rugova - për Hashimin kryeministër të qeverisë së përkohshme. [Këto komplete edhe ne idiotët e Lëvizjes i propagandonim si suksese të Hashimit...]

Kur amerikanët, gjermanët, anglezët, e kuptuan se DGSE-ja e kishte urdhëruar marionetën Thaçi, të mos e nënshkruante „marrëveshjen“, e bindën Presidentin e Francës, Jacques Chirac që të ndërhynte te DGSE-ja, tash për ta urdhëruar marionetën Thaçi që ta firmoste më 15 mars 1999 në Paris “Marrëveshjen e Rambujesë”.⁴⁰

Ajo zvarritje, mbi tre-javore, e nënshkrimit të marrëveshjes, ia pat mundësuar Serbisë të dislokonte ekstra trupa shtesë të ushtrisë dhe të policisë së saj në Kosovë që ta sforconin terrorin serb mbi popullatën civile shqiptare.

⁴⁰ Tepër komplotiste dhe destruktive e kam pas diskualifikuar gënjeshtren e Hashim Thaçit, i cili, për të kamufluar urdhrin e DGSE-së për refuzim të nënshkrimit të „marrëveshjes“ më 22 e 23 shkurt 1999, pat gënjyje organizuesit e Konferencës, bile edhe ministrat e jashtëm të USA-ve, Anglisë, Gjermanisë, se ndihet i kërcënuar me vrasje nga komandantët ekstremistë të zonave operative të UÇK-së, nëse do ta nënshkruante. Unë ua pata thënë disave diplomatëve operativë, të cilët na bënin presion edhe neve buzë Konfence, se Thaçi po gënjente, nga që nuk guxon të thotë se po e komandonte DGSE-ja; ai me atë gënjeshtër, njëherit, e kompromentonte qëllimisht UÇK-në si ushtri cubash. Ndonjëri nga diplomatët që kishte mosbesim ndaj sqarimeve të mija, u thosha ta takonin Sabri Kiçmarin, përfaqësuesin diplomatik të UÇK-së, meqë Sabriu po mbante kontakte telefonike me shumë komandantë të zonave dhe asnjëri nuk kishte kërcënuar. Përkundrazi deklaroheshin për respektimin e përfaqësimit politik të Delegacionit „kosovar“ në Rambuje...

Fatkeqësisht, komplotet e z. Taçi vazhduan edhe pas luftës, ndër të cilat, dy komplete ishin kryesore: I pari, simulimi i armiqësisë me Ibrahim Rugovën, për moskompletimin e “qeverisë së përkohshme”, të imponuar nga DGSE-ja franceze dhe RDB-ja serbe, dhe të firmosur nga kuislingët Taçi e Rugova, të krekosur, sikur vetëm ata dy kishin kompetenca, edhe për aso marrëveshjeje; I dyti, nxitja e armiqësive politike në mes të të ashtuquajturve “krahu i luftës” dhe “krahu pacifist”. Ky skenar, i sajuar nga shërbimet armiqësore, duhej të ndikonte në zhgënjimin e personaleteteve, partive, qeverive, që e kishin ndihmuar Kosovën, për sfidimin e agresivitetit fashistoid të Serbisë millosheviqiane.

Nxitja e armiqësive politike në vend, duhej të shkonte deri në atë shkallë, sa t’i hidhëronte e zhgënjente edhe shtetet vendimmarrëse për ndërhyrje të Aleancës NATO – për evitimin e katastrofës humanitare në Kosovë...

Fatkeqësisht, francezët nacionalistë, që kishin kapur Ushtrinë e Francës edhe DGSE-në e saj, na goditën edhe më rëndë sesa invadimi i ushtrisë ruse. Tash, serbofilin Arnaud Danjean, si epror i kryeshefit të UNMIK-ut, z. Bernard Kouchner, ishte angazhuar që gjatë qershorit 1999, ta “çlironte” veriun e Kosovës nga UÇK-ja, duke e bërë atë vatër të nacionalizmit fashistoid serb. Kontribut të madh në terren - për komplotin e Ushtrisë franceze, në qershor 1999, ka dhënë edhe marioneta Hashim Taçi...

2.4.6. Jakup Krasniqi

Jakupi është viktimë tragjiko-komike. Është për keqardhje burgosja dhe akuzat kundër tij, për krime të luftës, si pjesëtar i NPK-së, të kryesuar nga Xhavit Haliti, Azem Sylja, Hashim Taçi dhe Rexhep Selimi.

Deri në angazhimin e tij në UÇK, Jakupi ishte kuadër i LDK-së pseudo pacifiste, që e komandonte kuislingu Ibrahim Rugova.

Në maj 1998 Jakup Krasniqi i ndodh një konflikt, pothuaj i rastësishëm, me komandantin Fehmi Lladrovci. Ky i fundit duhet ta ketë urdhëruar Jakupin ta mbyllte gjimnazin në Drenas, ku ai ishte drejtor, sepse nxënësit e tij mund të rrezikoheshin nga ndonjë sulm i forcave serbe, për t'u hakmarrë kundër UÇK-së, apo mund t'i kidnaponin nxënësit për të shërbyer si pengje shantazhuese, kundër UÇK-së. Jakupi duhet ta ketë kundërshtuar urdhërin e Komandantit Lladrovci. Ai kundërshtim motivoi NPK-në që ta caktonte Jakup Krasniqin për zëdhënës të SHP-së, ose siç prezantohej shpesh: “Zëdhënës i UÇK-së”!

Jakupi, fatkeqësisht, nuk kishte aq përvojë sa për të ditur se platformën politike për një ushtri, e cakton themeluesi i ushtrisë. Në mungesë të përvojës politike dhe i shtyrë nga pasionet e tij patriotike-romasntike, Jakupi duhet ta ketë formuluar tekstin për “betim të ushtarit”, tekst i ngarkuar me kërkesa kombëtare maksimaliste.

Me intervistat dhe me deklaratat publike të tij, si “Zëdhënës i UÇK-së”, kinse, “UÇK-ja po lufton për çlirim e bashkim të të gjitha trojeve shqiptare”, Jakupi e irritonte botën.

Atëherë as më vonë, ai nuk ka reflektuar për ato gabime aq të rënda. Përkundrazi. Për ato devijime, Krasniqi ka vazhduar të vetëlavdërohej, sepse ato i krijonin famë ndër patriotët naivë, të cilët nuk mund t'i dallonin prioritet kombëtare, racionale e pragmatike, në kohë, në hapësirë e në rrethana të caktuara.

Do të kisha dëshiruar që Jakupit t'i mundësohet mbrotja në liri, meqë ai nuk i përket asaj kategorie që kërcënon dëshmitarët, apo që arratiset.

2.4.7. Azem Sylja / “Daja i vogël”

Azem Sylën e kam takuar për herë të parë në Zvicër, kur ai ishte imigruar aty dhe e kishte paraqitur kërkesën për azil politik. Linte

përshtypjen e një njeriu të traumatizuar, si ish i burgosur politik shumëvjeçar. Në parqitje dukej gjysmë-analfabet, pavarësisht që i thoshin profesor, ashtu siç iu thonë mësuesve, në shkollat e mesme në Kosovë. Por ai nuk kishte as diplomë fakulteti.

Mbaj mend informacionin se në Fakultetin e kimisë, në Prishtinë, gjatë katër viteve të studimeve, Azemi nuk kishte kaluar asnjë provim profesional, pos lëndëve joprofesionale, paraushtarak dhe marksizëm, që ishin të detyrueshme për të gjitha fakultetet. Në ato lëndë, zakonisht, askush nuk merrte notë negative, jokaluere.

Për shkak të deficitit të atëhershëm për mësues, edhe pse nuk e kishte haberin, i është dhënë mundësia të angazhohej si mësues kimie në gjimnazin e Kievës, Komuna e Klinës.

Azemi e ka sajuar edhe një mashtrim spektakular. Ai paskësh doktoruar, në vitin 2006, në shkenca politike, në *Leibniz University Institute of Arts and Science* in Santa Fe (New Mexico),⁴¹ pa e ditur ku gjendet ai universitet, pa e ditur gjuhën angleze dhe pa pas të mbaruar as fakultetin, as e magistraturën.

Prezantova këto të dhëna biografike të Azemit, në mënyrë që prokurori dhe gjykatësit ta kenë parasysh nivelin e ulët të përgjegjësisë dhe talentin e tij për të blerë edhe doktoratë (internetike) nga ajo botë e largët, nëse nuk është vetëm mashtrim.

Më herët rrëfeva për sabotimet e tij, bashkë me ato të Xhavit Halitit, nga viti 1994 deri në mars 1998. Përherë kam pas dilema, nëse ishte marionetë e RDB-së së Serbisë, apo e sabotonte dhe e komplotonte UÇK-në sepse nuk kishte mendime më konstruktive.

Në mars të vitit 1998, në Tiranë, në terasë të lokalit “Piazza”, prapa Muzeut Kombëtar, si rastësisht Azemi më dezinformoi se ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së. Mezi e përmbajtja irritimin që

41

<https://web.archive.org/web/20101029222130/http://www.institutiifinancaveikosoves.org/eng/permanentpresident.aspx>

të mos përlëshem me të edhe fizikisht. Simulova qetësi, me shpresë se do marrë përgjigje konkrete në pyetjet, kush dhe kur e kishte emëruar, zgjedhur apo caktuar për komandant të UÇK-së. Zuri të belbëzonte akoma më shumë sesa e kishte defektin natyror. E kërcënova të mos guxonte më ta mashtronte edhe dikë tjetër, se do armiqësoheshim tepër brutalisht.

Meqë ZPS-ja dhe Dhomat e Specializuara janë formuar për të hetuar e gjykuar vetëm akuzat që ka ngritur parlametari Dick Marty, në Raportin e tij të miratuar nga Kishilli i Europës, më 7 janar 2011, unë nuk po i rrëfeja sabotimet e komplotet e tij kundër UÇK-së dhe luftës së saj çlirimtare. Ato i kam publikuar pjesërisht, gjatë e pas Luftë.

Megjithkëtë, nuk do ta anashkaloj, pa e kujtuar, dyshimin e atëhershëm dhe të tanishëm, se Azem Syla, bashkë me Xhavit Halitin, e kishin koordinuar vrasjen e Ilir Konushevcit / “Mërgimit”, i cili, bashkë me Qerim Kelmendin / “Demën” e Naim Hazirin / “Dilaverin”, po e udhëheqnin Sektorin e Logjistikës në Shqipëri, me kryebazë në Bajram Curr. Vrasja ka ndodhur në mëngjesin e hershmë (rreth orës dy) të datës 9 maj 1998, në Shqipëri. Kryevrasësi mercenar ishte Bislum Demiri, i cili atëherë ishte i punësuar në policinë shqiptare, në Bajram Curr, si shofer i shefit të policisë së atyshme, Jonuz Hyka.

Nuk do ta anashkaloj as një debat rastësor, që e kisha me bashkëveprimtarin Metush Zenuni (Dura), në facebook, më 3 maj 2016, në kohën kur ishte bërë karaxhoz mediatik një kriminel ordiner, spiun i policisë së Serbisë, me emrin Fahrendin Gashi / “Farku” (nga Shtimja e Kosovës).⁴²

Fahredini është duke vuajtur dënimin me burg, për krimet e bëra, duke qenë i komanduar nga Azem Syla. Pata menduar se Metush Zenuni kishte informacion, meqë është i asaj ane, nga ishte edhe

⁴² <https://insajderi.com/deklaruari-sëmurë-mental-zbulohet-duke-bërë-biznes-nga-burgu/>

“Faruku”, pranda e pata pyet. Përgjigjja e tij fillestare, siç janë komunikimet në këtë rrjet social, qe kjo. “E çuditshme është se daja [siç e thërrisim atëherë Azem Sylën] na e dha Farukun me vete kur kaluam ilegalisht kufirin nga Shqipëria në Kosovë. Pasi u futem në kufi ne ramë në pritë, ku pati edhe të vrarë. Faruku humbi për disa orë. Pasi shkuam në Demjan, pas disa orësh, erdhi Faruku. Tregimi i tij për takimin me një oficer serb dhe ardhja e tij gjallë tek ne ishin për dyshim. (...) Në atë luftë [Metushi e quan luftë pritën e ushtarëve serbë që e ruanin kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë, ku ra aradha e 64-të e rekrutuarëve që po shkonin për t’iu bashkangjit UÇK-së] u vra Haxhi Hoti, nga Rogova e Hasit. Me Farukun kemi rrugëtuar deri në Caralevë. Aty jemi ndarë. Unë dhe Reshati vazhduam për Kaçanik, ndërsa Sadikun e dërguam në Dobërdolan, te Ilaz Kadolli dhe Hysen Gega.”

Në pyetjen time, “Kur, ku dhe si ka ndodhur ajo tragjedi”?, Metushi më ka sqaruar: “Ngjarja ka ndodhur gjatë natës 7/8 qershor 1998.” Me Metushin kanë qenë edhe bashkëveprimtarët Sadik Halitjaha dhe Reshat Salihaj, të bashkorganizuar në Lëvizjen, që vepronte në Zvicër. Pra, fjala është për një aradhë prej 64 vetave, e përbërë kryesisht nga imigrantët shqiptarë që vullnetarisht iu kanë bashkëngjit UÇK-së.

Kalimin ilegal të kufirit e ka “koordinuar” (komplotuar) Azem Sylja, i cili Metush Zenunin, Sadik Halitjahën dhe Reshat Salihun, ua ka dhënë për spiunim Fahredin Gashit.

Pra, sapo kanë kaluar kufirin, mbi Vlahne, në Malet e Pashtrikut, Fahredin Gashi është shkëputur nga aradha në atë errësirë të mesnatës. Pas pak ushtarët serbë kanë hedhë në ajër raketa ndriquese dhe kanë shti drejtë 64 vullnetarëve të UÇK-së. Në atë rast është vrarë Haxhi Hoti dhe janë plagosur shumë vullnetarë të tjerë.

Ky komplot përforcon dyshimin tim se Azem Syla ishte marionetë komplotiste, e rekrutuar më herët nga SDB-ja, tashmë e riemërtuar në RDB. Fatkeqësisht ne asnjëherë nuk kemi pas kurajë e vullnet të hulumtojmë shumë vrasje që kanë ndodhur gjatë kalimit ilegal të atij kufiri famëkeq. Ta zëmë, rasti tepër tragjik i Komandantit Mujë Krasniqi, i cili, bashkë me 41 bashkëluftëtarë është martirizuar gjatë natës së 13/14 dhjetorit 1998, duke e kalua ilegalisht atë kufi me 140 luftëtarë.⁴³ Asnjëherë nuk kemi bërë pyetje, nëse edhe asaj radhe Azem Syla ua ka besuar për “shoqërim” Fahredin Gashin apo ndonjë “faruk” tjetër!!

Edhe vrasja e kryeshefit të SHSSH (SDB-së), Ibush Kllokoqi, më 6 gusht 1999, për bindjen time është bërë me urdhër të Azem Sylës. Këtë bindje e kam formuar në një bisedë rasti në Prishtinë. Demë Nikçi, i afirmuar si “eksportues” i shqiptarëve në Amerikë, më pat lutur të shkoja me të në një lokal, ku e kishte lënë një takim me një ish-ushtar të UÇK-së, i cili kërkonte ndihmë nga Dema, për t’u arratisur nga Kosova. Ish-ushtari ishte Bekim Syla. Ai u prezantua si nip i Azem Sylës. Gjatë rrëfimit ankues iu mbushen sytë më lotë: “Azemi na ka urdhëruar ta vrasim Ibush Kllokoqin, e tani nuk paguan as avokat për mua dhe nuk përkujdesët as për t’i ushqyer bashkëshorten dhe dy vajzat e mija”, foli Bekim Syla. [Parafrazim]

Ato ditë Bekim Syla jetonte në arrati, sepse kishin filluar hetimet për rastin Kllokoqi. E këshillova të mos arratisëj, sepse, sapo të identifikohëj, secili shtet do ta kthente në Kosovë.

Edhe këtë e kam vlerësuar për dëshmi kokëforte, se Azem Syla ka zbatuar një urdhër që duhet të ketë qenë nga RDB-ja serbe. Pra, edhe nga ai takim rastësor m’u sforcua urrejtja për marionetën komplotiste Azem Syla – sepse kishte shpërdoruar një luftëtar trim, që besonte se Azemi vërtet kishte qenë komandant i UÇK-së!

⁴³ <https://telegrafi.com/renia-e-muje-krasniqit-dhe-41-luftetareve-te-uck-se/>

Ajo vrasje, si edhe vrasja e kryeshefit të SHSSH, Selim Brosha, duhet të jenë urdhëruar nga RDB-ja serbe, që të evitohet dekonspirimi i spinunëve që ata dy duhet t'i kishin rekrutuar. Nuk më besohet se Azemi, kokë më vete, - nga frika se ata do të mund ta dekonspironin përkatësinë e Azemit, - ka urdhëruar vrasjen e Ibush Klloloqin, ndoshta edhe të Selim Broshës. Nëse i ka vra për hakmarrje, sepse ata duhet ta kenë tortuaruar gjatë hetimeve kur e kanë burgos Azemin në vitin 1981, edhe do të mund ta arsyetoja, por ne ishim përcaktuar për pajtim kombëtar – kundër hakmarrjeve.

Njerëz të informuar mirë më kanë thënë se, natën e vrsjes së Ibush Klloloqit, ka feshuar edhe Sabri Novosella, sepse është çliruar nga ankthi që Ibushi do të tregonte se Sabriu ishte rekrutuar nga SDB-ja...

Nuk po rrëfej për krime të tjera të Azem Sylës, sepse ato, tashmë, janë publikuar.⁴⁴

2.4.8. Xhavit Haliti / “Zeka”

Me shpresë se edhe Xhaviti do të akuzohet e prangoset nga ZPS-ja, - sepse edhe ai, bashkë me Azemin, Hashimin e Rexhepin, ishte komandant i NPK-së, - po prezantoj disa informata biografike për te.

Për Xhavitin kisha dëgjuar qysh kur isha në shkollë të mesme, në Pejë. Për të më rrëfente edhe shoku i bankës, Haxhi Neziri i Radavcit të Pejës, i cili kohë pas kohe shoqërohej me një grup “trimash”, në fakt huliganësh, që në atë kohë garonin me grupe të tjera, në Kosovë. Ky ishte njëlloj hobi kriminal, por që vetë pjesëtarët e atyre grupeve e vlerësonin, pothuajse, si sport.

Edhe Xhaviti i përkiste një bande dhe vërtet shquhej për trimëri, por për trimëri huligane. Trupin e kishte të mbushur me gjurmë plagësh të shumta, thikash e plumbash, nga garuesit e sillojit të tij. Kur ishim

⁴⁴ <http://www.veriu.info/krim-i-organizuar-tjetërsim-pronash-pastrim-parash-azem-syla-sot-del-para-gjyqit/>

shokë, kisha keqardhje për te, pse e kishte shpërdoruar aq vulgarisht trimërinë e tij. Ndonjëherë, shkas për ato zënka ishin edhe garat për përvetësimin e pevaqicave (siç u thoshim ca këngëtareve ordinere serbe, që këndonin në lokale ordinere në Kosovë).

Babai i Xhavitit, një burrë shumë fisnik, kishte emigruar në Gjermani dhe, pothuaj, gjithë pagën e tij ua dërgonte bashkëshortës e fëmijëve në Kosovë. Xhaviti, si fëmija i parë, i shpërdoronte për aventura të tij huliganeske. Kështu reflektonte, herë pas here, vetë Xhaviti Haliti, gjatë bashkërrugëtimeve tona të gjata, në shtete Perëndimore (Xhavi vozitës, meqë nuk kisha leje për vozitje).

Nga viti 1973, kur fillova studimet në Fakultetin e Fizikës të Universitetit të Prishtinës, Xhavitin nuk e kisha më në radarin tim të vëmendjes. U befasoja kur Xhaviti u "arratis" nga Kosova dhe kërkoi azil politik, në Zvicër. Ai u integrua shpejt në Lëvizje, falë Emrush Xhemajlit e Ali Ahmetit, të cilët Xhavitin e prezantuan si militant të OMLK-së.⁴⁵

Fakteqësisht, penetrimi i Xhavitit në Lëvizje edhe në emigracion, na shkaktoi telashe, sepse disa bashkëvendas e njihnin konkretisht Xhavitin dhe veprimtarinë e tij kriminale e "patriotike". Megjithë-

⁴⁵ Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës ishte themeluar në vitin 1975, nga Mehmet Hajrizi, Xhafer Shatri, Hidajet Hyseni, Binak Ulaj dhe të tjerë. Në viti 1980 emrtohet: OMLK. Në emigracion atë e përfaqësonte gazetari Kadri Zekaj, të cilin, bashkë me Jusuf e Bardhosh Gërvalla, i vrau shërbimi policesk jugosllav, më 17 janar 1982. Meqë gjatë vitit 1981 policia e KSA të Kosovës pat arrestuar të gjithë anëtarët e OMLK-së, Kadri Zeka vazhdoi ta mbante gjallë atë akronim. Më 17 Janar 1992, bashkë me Jusuf Gërvallën dhe Ibrahim Kelmendin, bashkohen dhe themelojnë Lëvizjen për Republikën Kosovës, e cila në vitet e 1990-ta u riemërtua Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Edhe pse, pas 17 janarit 1982 nuk ekzistonte më as formalisht OMLK-ja, disa militantë, në krye me Xhabir Morinin, bashkë me Hajtin Abazin /"Lum Haxhia" (që duhet të ketë qenë dy muajt e fundit anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së), Emrush Xhemajli / „Muhameti“, Ali Ahmeti / „Abazi“, dhe bashkëveprimtarë të tjerë të tyre, improvizuan vazhdimësinë e ekzistencës së OMLK-së. Në atë OMLK duhet të jetë penetruar Xhaviti Haliti, me urdhër të Shërbimit policesk të Serbisë...

këtë, dëshironim të besonim se ishte përmirësuar, prandaj e pranuan për bashkëveprimtar.

Deri në vitin 1991 Xhavitin e kam çmuar si bashkëveprimtar të vyer e të shkathët. Prishja mes nesh ndodhi në vitin 1991, kur e venorova që ai po e penetronte e afirmonte kriminelin “ndërkombëtar” Hajdin Sejdia në Tiranë.⁴⁶

[Hajdinë Sejdia ishte kuadër i kalibrit të madh të SDB-së federative të ish-RSFJ-së, e cila Hajdinin e kishte angazhuar si marionetë komplotiste në Tiranë. Xhavit Halili ishte shkues i kriminelit Hajdin Sejdia. Ai në vitin 1991 formoi firmën e parë piramidale në Shqipëri, duke e rrezikuar ekzistencën e Shtetit shqiptar, në mars 1997).

Mund të ketë qenë viti 1995, kur aksidentalisht plasi një konflikt mes meje dhe Xhavitit. Ishim në banesën e Gafur e Vera Elshanit, në Aarau të Zvicërës, në pritje të fillimit të mbledhjes së KP-së së Lëvizjes, kur Xhaviti më akuzoi se po e përkrahja Mehmet Bislimin, nga Prekazi, ekzilant në Zvicër, për gjoja simpatinë që kisha ndaj tij, për rrahjen që Mehmeti me shokë ia kishin bërë Xhavit Halitit gjatë demonstratave të Pranverës 1981, në Prishtinë. Ishte herë e parë që u informova se Xhavitit i kishte ndodhur ajo rrahje nga studentët (1981), të cilët dyshonin se Xhaviti ishte spiun i shërbimit policesk të Kosovës – SDB-së.

Me Xhavitin u përplasëm prapë, në verë të vitit 1996, kur nga Kosova na erdhi informata se Fondi VTH, nuk po e ndihmonte financiarisht UÇK-në. Pas asaj përplasjeje, Kryesia e Lëvizjes më thirri të jepja llogari “pse Kryesia e Nëndegës së Lëvizjes në Gjermani, iu kishte dërguar pak ndihma simbolike financiare grupeve guerile të UÇK-së”, në Drenicë, e komanduar nga Adem Jashari; në Llap e Gollak, nga Zahir Pajaziti; në Dukagjin nga Adrian Krasniqi. Në atë mbledhje u informova se për Xhavit Halitin dhe për

⁴⁶ <https://lajmi.net/biznesmeni-kosovar-ajdin-sejdia-po-akuzohet-ne-shqiperi-per-pastrim-parash/>

Azem Sylën, “grupi” i Adem Jasharit dhe “grupi” i Zahir Pajazitit, nuk ishin fare pjesë e UÇK-së. Ata, Xhavitit dhe Azemi, prandaj, nuk iu kishin dhënë ndihma financiare atyre grupeve.

Fatkeqësisht, qysh kur e kemi themeluar Fondin VTH, më 4 dhjetor 1993, deri në maj 1998, të gjitha ndihmat financiare të Fondit VTH, kanë përfunduar në duar kryesisht të Xhavit Halitit, ndonjëherë edhe të Azem Sylës. Ata, pastaj, një pjesë simbolike të atyre ndihmave financiare ua kanë dërguar Nait Hasanit, Rexhep Selimit e Sokol Bashotës, të cilët e simulonin ekzistencën e “shtabit qendror” (pararendës i “shtabit të përgjithshëm” të NPK-së).

Përplasjen tjetër e kishim kur ndodhi vrasja e Ilir Konushevcit, më 9 maj 1998. Unë dyshoja në Xhavit Halitin dhe Azem Sylën, si financues të vrasësve mercenarë.⁴⁷

Dubioz është bashkëpunimi i Xhavitit Halitit edhe me “kryeministrin” kuisling, Bujar Bukoshi, nga i cili ka marrë shumë miliona USD dhe DM, gjoja si ndihmë për UÇK-në.

2.4.9. Rexhep Selimi / “Dhetshi”

Rexhep Selimi është personalitet i afirmuar, tashmë, për mirë dhe për keq. Takimi i parë dhe njohja ime me Rexhepin duhet të ketë qenë në qershorin e vitit 1999, në Prishtinë. Rexhepi atëherë simulonte, me fodullëk, ministrin e brendshëm në “qeverinë e përkohshme” të Hashim Thaçit.

Meqë qysh në fillim ishim keqkuptuar, nuk kemi mundur të bëhemi miq, as sa për “rënd të gjerave”. Pyetjet e mija, sa mjete kishte pranuar “shtabi qendror”, nga dhjetori 1993 deri në janar 1998, përse “shtabi qendror” nuk i ka njohur për pjesëtarë të UÇK-së Adem Jasharin me bashkëluftëtarë dhe Zahir Pajazit me bashkëluftëtarë, përse nuk u është përgjigjur pyetjeve që ia ka bërë Bedri Islami, që

⁴⁷ Intervistë e Xhavit Halitit, më 05.06.2019:
https://www.youtube.com/watch?v=M_uMaEGPaMc

ishte udhëheqës i Gurpit hetimor, i formuar në maj 1998, për të hetuar akuzat që pat bërë Hashim Thaçi në MGP, etj., e patën hidhëruar Rexhepin dhe, që atëherë e tutje, i jemi shmangur njëri-tjetrit, në takimet e rastit, në rrugë apo në lokale të ndryshme.

Unë kam dyshuar që Rexhepi i kishte qitur në pritë të policisë serbe, Zahir Pajazitin, Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën, më 31 janar 1997. Rexhepi, prandaj, nuk iu është përgjigjur pyetjeve të Bedri Islami. [Rezultatit e atij hetimi, Kryetari i Kryesisë së Lëvizjes, Bedri Islami, e ka prezantuar në librin e tij “Enigma e një vrasje të trefisht”.⁴⁸]

Peng më ka mbetur një informatë e historianit Hakif Bajrami, i cili e ka shkruar një studim për Zahir Pajazitin.⁴⁹ Në konfidencë, Profesori Bajrami më pat thënë se gjatë hulumtimeve për veprimtarinë e Zahir Pajazitit, ka dëshmi, edhe me shkrim, se në rrugën Prishtinë-Mitrovicë, të bllokuar nga policia serbe, më 31 janar 1997, ku i ishte ngritur prita Zahir Pajaziti, ishte identifikuar Rexhep Selimi.

Hetuesia e Kosovës, fatkeqësisht, nuk ka ndërmarrë hetimet për ato vrasje „enigmatike“, edhe pse shpeshherë asai i janë bërë edhe kërkesa publike.

Në vitin 2006, policia hetimore e Kosovës, e kryesuar nga Fadil Syleviqi, pat sajuar një „grup“, si gjoja organizues të trazirave të vitit 2004. Në atë „grup“ e kishin përfshirë edhe vëllain tim. I shqetësuar për atë padrejtësi, u angazhova për të hulumtuar, kush ishte kryekomplotisti. Më rezultoi se ai ishte Fadil Syleviqi. Gjithashtu, u informova se Rexhep Selimi kishte miqësi të madhe me Fadil Syleviqin. Rexhepin e gjeta në një rostan, për të cilin thuhej se është i tij. Ai

⁴⁸ Bedri Islami, „Enigma e një vrasje të trefisht“, Botues Fokus, Prishtinë 2007, ISBN 9951560059 dhe 9789951560054; teksti i librit:

<https://zeflushmarku.edu.mk/libra/enigmaenjevrasjejislami.pdf>

⁴⁹ <https://www.radiokosovaelire.com/akademik-prof-dr-hakif-bajrami-filozofia-politiko-strategjike-e-zahir-pajazitit-hakif-zenullahut-dhe-edmond-hoxhes/>

më pat thënë se për hatër të vëllit tim do të intervenonte te Syleviqi por „qenka bërë vonë, meqë procesi gjyqësor kishte filluar“...

Në atë rast e pyeta, nga e kishte gjithë atë miqësi me Fadil Syleviqin. Rexhepi m'u përgjigj: „ka qenë pjesëtar shumë i vlefshëm i UÇK-së“. U trondita. „Edhe pse e ka zhdukur mjekun Hafir Shala?!“⁵⁰ ia ktheva dhe u largova nga tavolina ku isha i ulur vetëm me të.

Rexhepi më ka neveritur, kur, gjatë një rrëfimi të tij, në një emision televiziv, pat thënë se, pasi kishte darkuar në byrektorën „Bosna“, përballë pallatit të Radio Prishtinës, në Prishtinë, kishte shkuar pra-pa pallatit, ku ishin ca gjermadha që i qaunim „pavione“, dhe aty e kishte hedhur një granatë xhepi, për t'i trembur refugjatët serbë, që pushteti serb i kishte strehuar aty. Nuk i kishte hije gjithë atij „komandanti“ të shiste madhëri me atë akt zuzar, sepse edhe refugjatët serbë, nga Bosnja, ishin viktimat, që po shpërdorshin nga pushteti serb për të shtuar përqindjen e popullsisë serbe në Kosovë.

Edhe një rrëfim i tij për „shtabin qendror“, bërë para disa muajve: “Shtabi qendror nuk kishte komandant, ishim udhëheqje kolegjiale e shokëve të barabartë“. Atë (dez)informim e pata keqkultuar si dilitantizëm të tij, në çështjet ushtarake, edhe pse ai vetë krekosej se kishte rol të madh komandues në UÇK.

Urrjetje të madhe për të më pat shkaktuar (dez)informimi publik që pat bërë Ramiz Lladrovci, kur pat thënë: “Rexhep Selimi e ka dëbuar gjatë luftës Bekim Berishën⁵¹ nga Kosova...” [Parafrazim.]

Habit fakti që parlamentari Dick Marty nuk e ka akuzuar edhe Fadil Syleviqin për krime, meqë, sipas Rexhep Selimit, edhe Fadili paskësh qenë kuadër i rëndësishëm i UÇK-së!

⁵⁰ Dr. med. Hafir Shala, i arrestuar më 10 prill 1998, nga eskorta e policisë serbe, në shoqërim edhe të kryepolicit kolaboracionist shqiptar Fadil Syleviqi (tani kryeshef në një departament policor në Prishtinë);

<https://www.youtube.com/watch?v=a5Q58nWUm2I>

⁵¹ https://en.wikipedia.org/wiki/Bekim_Berisha

Nuk po vazhdoj të prezantoj të tjerë anëtarë të SHP, meqë tashmë, më dezorintoi informimi që e lexova në portalin „Koha“, sipa të cilit kryeprokurori i ZPS-së, Z. Jack Smith, paskësh thënë:

„Në intervistat e tij me ZPS-në, z. Thaçi hodhi poshtë çdo përgjegjësi për krimet e kryera nga pjesëtarët e UÇK-së, duke pohuar në mënyrë të përsëritur se në asnjë moment, më 1998 ose 1999, ai ose ndonjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm nuk kanë pasur ndonjë autoritet mbi UÇK-në.⁵²

Menjëherë e bëra status në FCB, duke e shoqëruar vetëm me: „no coment!“⁵³

Në fakt, unë kisha vendosur të rrëfeja sa më shumë fakte, për të dëshmuar se UÇK-ja nuk ishte ushtri në kuptimin klasik të emrit, aq më pak ishte ushtri që komandohej nga NPK-ja! UÇK-ja ishte emërtim simbolik i Kryengritjes së armatosur çlirimtare të mijëra trimava e trimëshave, të cilët e vranë frikën; atë frikë që e kishte imponuar pushteti fashistoid serb, me angazhimin edhe të kuislingëve, të kolaboracionistëve, të marionetatve dhe të spiunëve shqiptarë, për ta rritur frikën ndër shqiptarët.

Këta, të katapultuarit në krye të partive “legale” (LDK dhe parti të tjera, të regjistruara në Beograd), si gjoja pacifistë e demokratë, përhapnin psikologji frike që të mos guxonim t’i kundërshtonim e t’i luftonim forcat pushtuese të Serbisë, sepse, Serbia paskësh kapaci-

⁵² https://www.koha.net/arberi/247026/thaci-ne-speciale-eshte-distancuar-nga-uck-ja-ka-thene-se-shtabi-i-pergjithshem-skishte-autoritet/?fbclid=IwAR2kEjXAiQ2BvI-8DYyf6dPcsJAqEawIAyDRMSite0uy_ok7ixQZKn8xcS8

⁵³

<https://www.facebook.com/photo?fbid=1339999023018280&set=a.120495504968644>

tete ushtarake të na zhdukte brenda dy ditëve. Ngjashëm po veprojnë edhe tani, duke propaganduar kërcënimet e Vuçiqit.

Pas plojes në Prekaz, kundër familjes Jashari (5-7 mars 1998), deri me 10 apo 11 qershor 1981, kur NPK-ja simuloi formimin e Shtabit të Përgjithshëm, UÇK-ja ishin vetorganizuar dhe tashmë i kishte mbi **dhjetëmijë** kryengritës. NPK-ja, deri atëherë, ishte angazhuar në sabotimin dhe komplotimin e atij shpërthim eksploziv të kryengritjes dhe atë vetorganizim. Kryengritësit vetë e improvizonin organizimin ushtarak, duke zgjedhë e votuar komandantët e njësiteve kryengritëse të tyre për komandant.

Sabotimi e komplotet më efektive bëheshin duke ia grabitur UÇK-së ndihmat financiare, të grumbulluara nga emigrantët dhe qytetarët e Kosovës,⁵⁴ duke penguar futjen ilegale, më masive, të armëve dhe municionit nga Shqipëria në Kosovë, duke korrumpuar ndonjë luftëtar të afirmuar, për të nxitur konflikte kundër atyre që, tashmë, ishin afirmuar si komandantë të kryengritësve. Etj.

Askush nuk mund të ofrojë dëshmi konkrete, se deri në qershor 1998, ishte zgjedhur, emëruar apo caktuar, ndonjë komandant i UÇK-së në Kosovë, qoftë nga NPK-ja, qoftë nga kryesia e Lëvizjes, e

⁵⁴ Sipas disa përlllogaritjeve hamendësore, NPK-ja ia ka grabitur UÇK-së rreth 70 % të ndihmave financiare që i kanë dhënë emigrantët dhe qytetarët e Kosovës. Nga maji 1998 isha përcaktuar të mos i shkonte NPK-së asnjë qindarkë nga ndihmat që dorëzoheshin në Zyrën qendrore të Fondit VTH, në Bonn, por me to të ndimonim UÇK-në në terren. Megjithatë, në fund të majit apo fillim të shkurtit 1999, NPK-ja më pat mashtuar dhe i pata dërguar 8 milionë DM, të cilat përfunduan në kthetra të kriminelëve. 4 milionë DM i patën transferuar me auto Mark Bardhaj, nga Peja, me banim në Bochum /Gjermani, dhe Vesel Bacaj, nga Pepajt e Malit të Zi, atëherë me banim në Euskirchen. Ato i ka pranuar në Lubljanë Gani Thaçi, vëllai i Hashimit dhe i kanë mbajtur në kthetra familjare. 4 milionë DM, në të njëjtën ditë, i ka transferuar Ibrahim Iberdemaj i Nabergjanit të Pejës, me banim në Nçrnberg. Në Austri i ka pranuar argati i Xhavit Halitit, Fatmir Zymeri, me banim në Oslo (pronar i rrjetit tregtar Yusk). Bile në rastin e Fatmirit më ka telefonuar banka austriake për të dëshmuar origjinën ose ato mjete do konfiskoheshin e Famiti do të burgosej. Por, Sparkasse në Bonn sqaroi kolegët në Austri, se ato mjete i kishim tëheq nga banka një ditë përpara...

viteve 1993-maj 1998 dhe kryesia e pas majit 1998, deri në qershor 1999 (anëtar së cilës isha edhe unë), qoftë nga SRV-ja, e zhbërë në mars 1998.

Shkurt dhe shqip, siç e përdorim si zhargon në kësi rastesh, UÇK-në gjithëmonë e kam karakreizuar si Kryengritje të armatosur çlirimtare të Vegjëlisë së Kosovës, që e ka sfiduar edhe “uçk” e pseudokomandantëve të “shtabit të Rognerit”, që kësaj radhe edhe unë i diskualifikova si NPK.

Për ata që vonohen për të kuptuar, po e përsëris edhe një herë: UÇK-ja e Kosovës, pos Serbisë pushtuese, fatmirësisht i ka sfiduar edhe Marionetat e shërbimeve armiqësore (NPK-në); Qeverinë shqiptare, në krye me kryeministrin kuisling Fatos Nano; “Qeverinë” e pseudokryeministrit kuisling, Bujar Bukoshi dhe pjellën e tij, FARK-un diverzionist (siç ishte deri në shtator 1998)!

Fatmirësisht, **falë** edhe ndihmës **mrekulluese**, nëse mund të thuhet ky lloj poetizmi, të Alenacës NATO, - e cila ndërhyri vetëm për të evituar katastrofën humanitare në Kosovë, e Jo për hir të UÇK-së; As se ishte aleate e UÇK-së; As për hir të shallit të Ibrahim Rugovës, siç mashtronin marionetat komplotiste dhe shumë spekulantë, të cilëve u pëlqen të thonë atë që kanë dëshiruar të ndodhin, e jo atë që vërtet ka ndodhur; - Kosova, më në fund, me shumë martirë, sakrifica, viktima, dëme, u çlirua nga pushtimi i Serbisë fashistoide me 12 qerdhor 1999, pas rreth 86 vjetëve të pushtimit e sundimit serb!

Do të ishte e mangët kjo dëshmi nëse nuk do të thoja asgjë për aleatet kryesor të NPK-së: “qeverinë” e Bujar Bukoshit dhe FARK-un (Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës).

Po e shpërdoroj, për një moment, fantazinë prej shkrimtari:

RDB-ja e Serbisë, e pasigurt në suksesin e planit A të saj, duhet ta ketë sajuar edhe planin B.

Planin A: përmes marionetave Xhavit Haliti, Azem Sylja, Hashim Thaçi e Rexhep Selimi, ajo kishte qëllim ta mbante gjallë një “uçk” fantazmë dhe me atë “uçk”, Policia serbe të bënte “fizkulturë”, kohë pas kohe.

Planin B: paralelisht me përgatitjen e sulmit tejet goditës kundër UÇK-së, siç duhet ta kenë kualifikuar sulmin ndaj Familjes emblematike Jashari, në Prekaz, RDB-ja duhet t’i ketë urdhëruar marionetat Ahmet Krasniqi dhe Bujar Bukoshi ta formojnë ushtrinë “institucionaliste”. Pra, kur në Prekaz të Drenicës, nga ushtria e policia serbe po rrethoheshin Jasharët, Koloneli Ahmet Krasniqi, më 3 mars 1998, i thirri fillimisht dy-tre ushtarakë, në banesë të tij, në Cyrih të Zvicrës, dhe ua paraqiti Planin e tij për formimin e ushtrisë, me emrin Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Dy-tri ditë më vonë, Planit të kolonelit Krasniqi, iu bashkuan edhe disa ushtarakë të tjerë, për ta formalizuar Kolonelin Ahmet Krasniqi si komandant të FARK-ut të tyre, të sapoformuar. Ata e zgjodhën edhe një “delgacion” që të takohj me “kryeministrin” Bujar Bukoshi. Ky i fundit i priti më 7 mars 1998. Ja, kaq u dashtë që të “institucionalizohej” FARK-u diversionist e komplotist!⁵⁵

Për angazhimet, në ditët pasuese, të këtyre komplotistëve nuk kam informacion konkret.

Në një debat rasti, para rreth dy vjetësh, bashkëveprimtari Idriz Mehmeti⁵⁶ (nga një fashat i Drenicës, tani jeton në Bern të Zvicrës), pat rrëfyer: “Kur përfunduar ceremoninë mortore disa ditore në Gjermani, te Rifat Jashari,⁵⁷ u kthehva në Zvicër. Ishte pothuajse

⁵⁵ Informacion konkret ka publikuar vet zëvendësi i Ahmet Krasniqit, Koloneli Agim Mehmeti në librin e tij: “E VËRTETA PËR FARK-un” (2014) <http://floripress.blogspot.com/2014/02/librie-verteta-per-fark-un-nga-agim.html> <https://www.youtube.com/watch?v=I7g4wUkelUI>

⁵⁶ <https://www.facebook.com/idriz.mehmeti.568>

⁵⁷ Vëllai i madh i Adem dhe Hamzë Jasharit.

fundi i marsit 1998, kur më telefonoi një person i panjohur. M'u prezantua me emrin Ahmet Krasniqi i Zhilivodës dhe më tha se e kishte pyetur ministrin Xhafer Shatri⁵⁸, se si mund t'i takonte djemtë e UÇK-së. Xhaferi ia kishte dhënë numrin e tel. tim dhe i kishte thënë se unë mund të aranzhoja takimin që e dëshironte Ahmeti. Unë konataktova me Hashim Thaçin, meqë ende ishte në Zvicër, i tregova për interesimin e Ahmetit dhe, bashkë me Hashimin, shkuam të Ahmeti në Cyrih. Ata kanë biseduar mes tyre rreth 8 orë..." [parafrazim].

Meqë në Tiranë, gjatë marsit 1998 (pas datës 8), po merresha me strehimin e ushtarakëve "kosovarë", që jetonin në Bosnjë, Kroaci, Slloveni, Zvicër dhe shtete të tjera në Perëndim, por që donin të përfshiheshin në UÇK, ushtarakët më lutën t'ua mundësoja një takim me "kryeministrin" Bujar Bukoshi. E shfrytëzova njohjen që kisha me prof. Shemsi Reçicën, (i angazhuar në zyrën e Bukoshit, në Bon, si kryetar i Grupit Emergjent, i zgjedhur nga përfaqësuesit e LPK-së, LDK-së, LKÇK-së, BSHGJ-së, etj.) dhe ai, më 17 mars 1998, e aranzhoi takimin që u mbajt në ambientin e "amabasadës" së Kosovës në Tiranë. Në takim ishin rreth 15 ushtarakë, ndër të cilët, Halil Bicaj, Naim Maloku, Bislim Zyrapi, Fadil Demiri, Fuat Ramiqi, etj. Në atë takim ishe edhe unë (Ibrahim Kelmendi). Aty ushtarakët kërkuan që UÇK-ja të institucionilizohej si ushtri e Republikës së Kosovës, komandant të caktohej një ushtarak i dëshmuar në luftërat kundër Ushtrisë së Serbisë, në Kroaci e Bosnjë. Ata kundërshtuan

⁵⁸ Xhafer Shatri është burgosur në Kosovë në vitin 1975, me akuzë se ka formuar Organizatën Revolucionare të Kosovës. Ka deklaruar se është arratisur nga burgu i Prishtinës në fund të marsit 1982. Është prezantuar si udhëheqës i OMLK-së dhe më 9 maj 1982 e ka shpallur „bashkimin“ e OMLK-së me LSSHJ-në, të cilën e kishin kompiluar Sabri Novosella dhe Avdullah Prapashtica, më 17 shkurt 1982. Në vitet e 1990-ta e kanë bërë „ministër për informim“ në „qeverinë“ e Bujar Bukoshit.
<https://www.facebook.com/xhafer.shatri>
<https://xhafershatri.info/>

caktimin e Ahmet Krasniqit për komandant, sepse e dyshonin për shkak të angazhimit të tij në ushtrinë serbe, në luftime kundër ushtrisë kroate gjatë lufte në Kroaci. Bujar Bukoshi e mbrojti emërimin e Ahmetit me gënjeshtren se “Prishtina e ka caktuar Pikën”, siç e quante ai atëherë Ahmetin, për të simuluar konspiracion ushtarak. Kështu Bukoshi e ambalazhonte gënjeshtren e tij, sikur “presidenti” Ibrahim Rugova, e jo ai vetë, e kishte emëruar. U grindëm goxha shumë dhe nuk u mirëkuptuan për asgjë.

Duke parandjerë rrezikun për diversione goditëse nga FARK-u, i luta ushtarakët Fadil Demiri, Xhafer Jashari⁵⁹, Ramadan Gashi⁶⁰, Agim Haziri,⁶¹ që të angazhoheshin në shtabin e FARK-ut, në mënyrë që t’i pengonin angazhimet e tij diversioniste. Dhe, nëse s’do të mund t’i pengonin, ta informonin me kohë UÇK-në për planet dhe përgatitjet e Shtabit të FARK-ut. Për të mos u dekonspiruar, për këtë “plan” nuk e pata informuar asnjë bashkëveprimtar.

Meqë NPK-ja nuk po ia delte të sabotonte rritjen dhe konsolidimin e UÇK-së në Kosovë, Xhavit Haliti e ndërmori një veprim taktik, për të rritur autoritetin komandues të tij në UÇK. Ai e mori me vete Adem Demaçin në një takim famoz, që u mbajt në zyrat e Fatmir Zymerit dubioz, në Oslo, më 20 maj 1998. Në atë takim merrnin pjesë Xhavit Haliti, Adem Demaçi dhe Shaban Muja, si “përfaqësues” të UÇK-së dhe Ahmet Krasniqi e Agim Mehmeti si “përfaqësues” të FARK-ut. Për (mos)marrëveshjet e tyre në këtë takim, ty dy “palët” kanë rrëfyer versione të dallueshme mes tyre. Por tekst të marrëveshjes nuk kanë publikuar. Koloneli Agim Mehmeti, në librin e tij, ka publikuar shënimet e tij që i ka mbajt gjatë atij takimi...

⁵⁹ <https://www.facebook.com/xhafer.jashari>

⁶⁰ <https://www.facebook.com/ramadan.gashi.332>

⁶¹ Këta ishin shokë të Fehmi Lladrovci, ishin të informuar edhe nga Fehmiu për ca zhvillime të kohës, prandaj atyre iu besova e iu propozova që ta bënin atë shërbim, në dukje komprometues për ta.

Edhe ai takim ishte një komplot i koordinuar nga Xhavitit Haliti dhe Ahmet Krasniqi, kundër UÇK-së. Besoj, ata ishin kolegë, por simulojnë armiqësi publike, që komplotet e tyre të ishin sa më goditëse.

Më 25 qershor 1998. kolonelët Ahmet Krasniqi dhe Tahir Zemaj ia dolën të rekrutonin rreth 140 mercenarë. Ata, në krye me komandantin Zemaj, arritën në Dukagjinin e Kosovës, kinse kaluan ilegalisht, pa i hetuar fare Ushtria e Serbisë, në kufirin Shqipëri-Kosovës.

Koloneli Sali Vesli, në ndërkohë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, më ka pas rrëfyer se ai kishte dhënë urdhër që ajo brigadë të kthehej mbrapa, por Xhavit Haliti, “në emër” të shtabit të përgjithshëm, të pjesës që e komandonte NPK-ja, e kishte mashtaur Ramush Haradinajn, se, kinse, hyrja në Kosovës, e asaj brigade të FARK-ut, ishte pjesë e marrëveshjes mes dy shtabeve.

Deri në gusht 1998, pos pjesëtarëve të UÇK-së, edhe shumë civilë të paarmatosur kanë qenë viktimë të brigadës diversioniste të Zemajt. Megjithëkëtë, Serbia dhe z. Dick Marty e nuk kanë denoncuar asnjë komandantë të asaj brigade, edhe pse ka simuluar se ishte brigadë e UÇK-së! Dhe, meqë nuk e kanë akuzuar Serbia dhe z. Marty, as ZPS-ja, nuk duhet të ketë kompetenca për t’i hetuar krimet e saj!

Pasi kishte përfunduar misionin diversiv, koloneli Tahir Zemaj ishte kthyer në Tiranë. Ish shoku im i shkollës së mesme, Ramiz Muriqi, më ka treguar se ai (Muriqi) e ka lutur shefin e shërbimit të Malit të Zi, t’i nxirrte bashkë, Muriqin e Tahirin, nëspër Malit të Zi, deri matan kufirit Mali i Zi-Shqipëri.

Më 21 shtator 1998, koloneli Krasniqi e ka dekoruar kolonelin Zemaj, për suksesin e tij diversionist në Kosovë. Në mbrëmje të asaj dite Koloneli Krasniqi kishte planifikuar darkë festive me ushtarakët

që i komandonte, në restorantin “Nana Mbreteshë” në Tiranë. Pas dekorimit dhe në prag të darkës duhet të jenë grindur Ahmeti dhe Tahiri, prandaj Tahirit i pamundësohet pjesëmarrja në atë darkë. Duhet të jetë urdhëruar që, kinse për shkaqe sigurie, ta kalonte atë natë në “zyrat” e pseudo qeverisë së Kosovës, në Tiranë. Duke u kthyer nga ajo darkë, rreth orës 23, vritet koloneli Ahmet Krasniqi. “Fatmirësisht!”⁶²

Pas ca ditëve Koloneli Halil Bicaj⁶³, i shoqëruar nga Genc Kelmendi (nipi i Xhaxhait tim), më kanë vizituar në Bonn. Koloneli Bicaj, - me të cilin isha miqësuar shpejt, në muajin mars në Tiranë, edhe sepse ishte vëllai i Enverit, të cilin e kishim bashkëveprimtar të Lëvizjes, në Gjermani, - më pat kërkuar këshillë.

Koloneli Bicaj më informoi: “Kryeministri Bukoshi është përcaktuar për ushtarakun pejan Ismet Alia (i cili për momentin është atashë ushtarak i Bosnjes, në Turqi), që të jetë komandant i FARK-ut, në vend të Ahmet Krasniqit, tashmë të ndier. Meqë unë e kam kolegë dhe shok Ismetin, Bukoshi, në mirëkuptim me Ismetin, më ka lutur që atë përgjegjësi ta ushtrojë unë, deri në lirim të Ismetit nga qeveria e Bosnjes. Si mendon, a duhet ta pranohet kësaj ofertë?”, - më pyet Koloneli Bicaj. “Bingo!”, i jam përgjigj menjëherë. Që do të thotë, u dakordova për atë favor aq të volitshëm. Bicaj e këroi arsyetimin tim, i cili ishte: “Mjafton që marionetat dhe kriminelët e sojit Tahir Zemaj, të mos kenë më mundësi të rekrutojnë brigada të tjera diversioniste, që do ta shtypnin kryengritjen çlirimtare në krahina tjera, siç ndodhi gjatë gjatë vere në Dukagjin.”

⁶² Nuk po taktizoj as kësaj radhe për ta ndryshuar mendimin që kisha, se vrasja e kolonelit Krasniqi ishte sukses i madh për Luftën tonë çlirimtare, meqë më FARK-u ai përgaditi e futi në Kosovë brigada diversioniste. Uroj të dëshmohej se ai nuk ishte marionetë e regjimit të Millosheviqit.

⁶³ <https://www.youtube.com/watch?v=SEddYcur15Q>

Halilit nuk i mjaftoi vetëm miratimi im. Donte miratim edhe nga dikush tjetër, mundësisht me përgjegjësi më të lartë se unë, në LPK dhe UÇK. U dakordua dhe e lamë takimin, pas dy-tre ditëve, në Tiranë. Unë u përcaktova për konsultim me Ali Ahmetin. E kisha koleg, në Kryesi të Lëvizjes dhe Halili do të mendonte se Ali Ahmeti ishte edhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Aliu e miratoi përcaktimin tim.

Paraprakisht Aliu dhe unë e takuam kolonelin Bislim Zyrapi, tashmë komandant i Shtabit të Përgjithshëm, jo i atij shtabi që e përbënin Xhavit Haliti, Azem Sylja dhe Hashim Thaçi, me seli në Tiranë, por komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së së Vëgjëlisë kryen- ngritëse çlirimtare, në Kosovë.

Me Kolonelin Zyrapi kishta krijuar mirëbesim të madh, gjatë muajit mars e prill 1998, prandaj kisha besim në konstruktivitetin e tij dhe për ruajtjen e sekretit ushtarak, nga ana e tij. E sqarova se jemi vetëm ne, katër veta, që po vendosim për këtë plan dhe për të nuk duhet ta dijë askush, sidomos asnjë pjesëtar i bandave komplotiste të Xhavit Halitit dhe Tahir Zemajt. Përndryshe, do të dështonim dhe do ta rrezikonim edhe jetën, sepse ata e vrasin secilin që ua pengon seriozisht komplotet e tyre.

Takimin konspirativ, të ne të katërtëve, e bëmë në Picerinë “Artur”, përballë Muzeut piramidal, në Tiranë. Aty u dakordua që Luftën çlirimtare në Kosovë dhe logjistikën e saj në Shqipëri, ta koordinonin e komandonin Bislimi dhe Halili, duke simuluar dëgjueshmëri të shtirur, Bislimi ndaj NPK-së dhe Halili ndaj “kryeministrit” Bukoshi.

Fatmirësisht, këtë plan nuk e dekonspiruam asnjëri, deri pas luftës, dhe plani ruzultoi i suksesshëm. Aty e tutje kishim vetëm një ushtri, vetëkuptohet, në konsolidim e sipër, në ato rrethana tepër të vështira.

Fatkeqësisht as kolonelët Bislim Zyrapë e Halil Bicaj, edhe pse me përvojë të madhe në luftën e Bosnjes, nuk ia dolën ta asgjësonin krejtësisht NPK-në, që vepronte në kaudër të UÇK-së dhe në kuadër të FARK-ut, por komplotet e tyre, kështu, arritëm t'i minimalizojmë.

Përmbledhje:

- Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) e ka formuar Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme (M4P), mbajtur në Prishtinë, më 26-27 korrik 1993.
- Për formimin e UÇK-së dhe përkrahjen financiare e logjistike të saj, Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes, më 4 dhjetor 1993, i ka formuar Fondin "Vendlindja thërret" (FVTH) dhe Sektorin e Rëndësisë së Vëçantë (SRV), njëherit e ka ngarkuar Kryesinë që t'i caktojë personat e SRV-së dhe ta mbikëqyrë SRV-në.
- Deri në mars 1998, rritën dhe konsolidimin e UÇK-së, e kanë sabotuar kryesisht Xhavit Haliti e Azem Sylja, nga emigracioni, dhe Rexhep Selimi, brenda në Kosovë.
- Kryesia e Lëvizjes, e viteve 1993-prill 1998, ka dështuar në mbikëqyrjen e angazhimeve të SRV-së; Anëtarët e saj nuk kanë reflektuar asnjëherë.
- Në mars 1998, DGSE franceze, atëherë ndoshta më serbofile sesa RDB-ja serbe, e ka komanduar marionetën e saj, Hashim Thaçi, të anagzohet në sabotim e komplotim të UÇK-së. Kështu është kompletuar "Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale", siç e ka quajtur Krye-prokurori Smith, me të cilin po dakordohem edhe unë, edhe pse unë përpara e quaja bandë e "shtabit të Rognerit".

- Për shkak të sabotimeve e kompleteve, Lëvizja është detyruar të mbaj Mpledhje e 6-të të Përgjithshme (M6P), më 2-3 maj 1998. NPK-ja ka provuar ta kapte krejt Lëvizjen, por nuk pat sukses; NPK-ja ia doli ta fraksiononte Lëvizjen në: fraksionin por NPK-së, fraksionin anti-NPK-së dhe fraksionin “neutral”. Rolin kryesor për komplotim, gjatë M6P, e pat luajtur marioneta Hashim Thaçi, të cilin na e kontrabandoi Komisioni për verifikim të mandateve.
- Për të tejkaluar akuzat e shpifura të Hashim Thaçit, të plasura si granatë në M6P, u formua Grup hetimor, në krye me Bedri Islamini, i cili qe zgjedhur edhe Kryetar i Lëvizjes. Në korrik 1998, në mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm (KP) u prezantua rezultatit i hetimeve: Hashim Thaçi kishte shpifur për qëllime komplotiste. Fatkeqësisht Lëvizja, KP-ja dhe Kryesia, tashmë të fraksionuar, nuk qenë në gjendje të merrnin e zbatonin vendime të duhura kundër NPK-së.
- Shpërthimi i kryengritjes së armatosur çlirimtare i Vëgjëlisë çlirimtare të Kosovës (VÇK), në mars 1998, e frymëzuar nga martirizimi i Familjes Jashari, e gjeti UÇK-në pa komandantë e pa struktura ushtarake, me përjashtim të Sektorit të Logjistikës në Shqipëri, që e koordinonin Ilir Konushevc, Qerim Kelmendi dhe Naim Haziri.
- VÇL-ja e Kosovës u vetorganizua në Kosovë, nën Siglën UÇK, edhe pse atë e sabotuan dhe komplotuan NPK-ja, komanda e FARK-ut, “qeveria” e Bukoshit, qeveria e kryeministrit Fatos Nano dhe shërbimet e huaja armiqësore.
- Nën koordinimin e komandimit e Kolonelit Bislim Zyrap, zë fill formimi i Shtabit të Përgjithëm të UÇK-së, në Kosovë, të cilin NPK-ja u munda ta kapte plotësisht, në qershor 1998, por ia ka dalë vetëm pjesërisht, duke i mashtruar “ndërkombëtarët”, që donin të mashtr-oreshin, se NPK-ja ishte udhëheqja politike e UÇK-së; atëherë të gjitha qeveritë e shteteve të huaja, edhe qeveria e kuislingut Fatos

Nano, ishin të përcaktuara për sakrifikimin e Kosovës – lënien e saj nën pushtimin e Serbisë, me një autonimi të “zgjeruar”.

- Komandant i FARK-ut dhe “ministër i mbrojtjes”, në fillim të tetorit 1998, qe bërë koloneli Halil Bicaj. Ai fat i rastësishëm evitoi diversio-net e tjera në Kosovë, si në verë të vitit 1998, nën komandën e kolonelëve Ahmet Krasniqi dhe Tahir Zemaj, dhe evitoi formimin e dy e më shumë ushtrive armike shqiptare, siç kishte ndodhur në Kroaci dhe Bosnjë.
- Supërfuqitë e kohës, SHBA-ja, BE-ja dhe Rusia, gjatë vitit 1998 e sinjalizuan Serbinë se e kishte OK-ej të heshtur për ta asgjësuar UÇK-në, deri në pranverë 1999.
- Serbia dhe NPK-ja, kusilingu Bujar Bukoshi, i cili simulonte armiqë-si me kuislingun Ibrahim Rugova, nuk ia dolën ta shtypin UÇK-në e Vëgjëlisë çlirimtare të Kosovës!

Digresion:

Në vitin 1994 i kam shkruar një letër të gjatë “kryeministrit” Bu-koshi. Që ta impresiononte më shumë, luta Prof. Dr. Shefqet Can-hasin ta redaktonte. Ia pata paraqit konceptet dhe idetë për bashkëpunim në emigracion, që të mos formonte paragjykime të bazuara nga dezinformimet e shpifjet e tjerëve. Në vend që të më përgjigjej po me letër, Bukoshi me ftoi për vizitë në Weisshorn (qytetëz gjermane buzë Ulmi) në vilën e madhe që ishte ble me financat e “Fondit qeveitar3 %” (për të cilën nuk e di kush e ka përvetësuar). Në një moment më luti të thosha çfarë dija për te, meqë po e diskualifikoja për kuisling. Mes tjerash i pata thënë: “UDB-ja e diktaturës komuniste jugosllave angazhohej për të rekrutuar edhe të gjithë zadrugarët e polarët (siç i quanim pezhorativisht shitësat e rojet e fushave, që paguheshin nga shteti), në fshtrata më të largëta në Kosovë, e nuk iu paskësh

rekrutuar ju studentëve shqiptarë në Beograd?! Tjetra, pushteti i diktatorit Millosheviq po iu toleron ju “pacifistëve” pse i keni shallat e syzet e bukura?! Tjetra, Ibrahim Rugova dhe Ju, asnjëherë nuk keni biseduar qoftë vetëm 5 minuta, në cilësi të presidentit e kryeministrit, dhe asnjëherë Rugova nuk iu ka urdhëruar diç konkrete e Ju të keni refuzuar, as Ju nuk i keni propozuar diç konkrete, si kryeministri që i propozon kryetarit, sidomos në rrethana pushtimi. Etj. Atëhereë përse simuloni armiqësi mes jush?! Që të bëhet me pikante telenovela e “rezistencës pacifiste”. Bukoshi u zgërdhi: “Unë pata faja që të pyeta...”

- SHBA-ja, BE-ja dhe Rusia, pasi u binden që Serbia nuk po ia delte ta asgjësonte UÇK-në, u përcaktuan për një konferencë ndërkombëtare, e cila do ta viktimizonte Kosovën, duke e lënë nën pushtim të Serbisë, me një “autonomi” që do ta mbikëqyrnin trupat “ndërkombëtare”. DGSE-ja franceze duhet t’ia ketë dalë që ajo konfencë të mbahej në Francë, për të qenë e sigurt për komplotim të planifikuar.
- Deliranti fashistoid Slobodan Millosheviq, për fat tonin, nuk e pranoi “marrëveshjen” aq favorizuese për Serbinë, të cilën donin ta impononin organizuesit e Konfencës së Rambujesë.
- Marioneta Hashim Thaçi, i komanduar nga DGSE-ja serbofile, nuk e nënshkroi “marrëveshjen” më 23 shkurt 1999, duke gënjyer se po u frikësohej komandantëve ekstremistë të UÇK-së, sepse ashtu e kishte mësuar DGSE-ja të gënjente, për ta kamufluar urdhërin e saj. Komploti i Thaçit ia mundësoi Serbisë t’i dislokonte trupat e saj shtesë, nga Serbia në Kosovë, për t’i sforcuar masakrat dhe gjenocidin ndaj popullsisë civile shqiptare.
- Amerikanët, anglezët, gjermanët, austriakët e kuptuan, më në fund, se Hashimin e kishte komanduar DGSE-ja franceze, për mosnënshkrimin e “marrëveshjes”. Ato duhet ta kenë sqaruar e

përvetësuar presidentin e Francës, për ta urdhëruar DGSE-në që ta urdhëronte Thaçin për ta nënshkruante “marrëveshjen” në Paris, më 15 mars 1999.

- Deliranti fashistoid dhe kriminel i luftës, Slobodan Millosheviq, urdhëroi delegacionin serb të mos e nënshkruante “marrëveshjen” as në Paris, më 15 mars 1999. Kjo kryeneqësi e Millosheviqit i revoltoi amerikanët dhe anglezët. Ata, prandaj, u përcaktuan për “ndërrhyrje humanitare”, përmes bombardimeve ajërore nga NATO!
- Kuislingu Bujar Bukoshi, i shpërdoroi mbi NJË miliardë DM (marka gjermane), që emigracioni shqiptar i kishte dhënë, “si tatim” dhe ndihma, për luftën çlirimtare.

Digresion:

Në maj 1999 pata shtruar një darkë në Bonn, për hir të Migjen Kelmendit dhe Bukurije Gjonbalajt. Doja ta nderoja edhe funksionarit të atëhershëm në Ministri të Jashtme të Gjermanisë, z. Axel Dittmann, tani ambasador gjerman në Beograd (nga qershori 1999, këshilltar i kryeshefave të UNMIK-ut), i cili erdhi të informohej për gjendjen në Kosovë nga Migjeni e Bukuria. Rastësisht e aksidentalisht, pat shpërthyer një grindje mes nesh. Ai tha se ne po shkaktonim kritika Gjermanisë, pse po na toleronte ta përkrahnim aq hapur, politikisht e financiarisht, UÇK-në terroriste. Unë arsyetovea se ne kishim edhe të drejtën biologjike për t’u vetëmbrojt. Ai tha se ne kishim mjaft mjete financiare të grumbulluara deri atëherë, dhe, pasi t’i harxhonim ato, do të shiheshin mundësitë tjera për ndihmim. Për t’i arsyetuar fjalët e tij, i shpëtoi kjo informatë: “Bile keni aq shumë mjete, sa këto ditë Bujar Bukoshi dhe Isa Mustafa i transferuan në Beograd 500 (pesqind) milionë DM, por ende nuk e dimë kujt ia kanë dorëzuar dhe përse...” Ai, si duket, u pendua që i shpëtoi kjo informatë, dhe më luti të mos ua përktheja Migjenit dhe Bukurisë.

- Kuislingu Bujar Bukoshi ia ka dhënë dhjetëra milionë DM NPK-së së Xhavit Halitit, me urdhër të Beogradit, që NPK-ja të financonte kompletet kundër UÇK-së. Bukoshi ka financuar edhe FARK-un dhe ka korruptuar shumë protagonistë të atyre ngjarjeve. (Do të kishte qenë mirë që ZPS-ja të kërkonte dokumentacionin nga Banka Qëndrore e Shqipërisë për “Banka Dardania”, në Tiranë, dhe nga bankat në Perëndim, në të cilat i kishte xhirollogaritë Fondi i Bukoshit).
- NPK-ja e Xhavit Halitit dhe Hashim Thaçit, e katapultuar nga shërbimet armiqësore në “krye” të UÇK-së, i ka grabitur rreth 70 % të ndihmave financiare, që emigracioni patriotik dhe qytetarët e Kosovës i kanë dhënë për UÇK-në. Unë jam dakord që ZPS-ja të kërkojë kopje të dokumentacionit edhe të Fondit VTH - që na i ka konfiskuar BKA-ja gjermane, në qershor të vitit 1999. Aty janë të evidentuara, pothuajse, të gjitha ndihmat financiare në Gjermani, që janë menazhuar nga zyra jonë qendrore në Bonn. Atë dokumentacion e ka edhe Prokuroria në Bochum).
- Deri tani, në aktakuzën kundër Hashim Thaçit e të tjerëve, nuk kemi akuzime në bazë të Raportit të antiamerikanit Dick Marty, për “trafikim të organeve”. Kisha frikë që Beogradi mund ta kishte urdhëruar NPK-në për të bërë edhe atë lloj krimi, që ta kompromentonte sa më vulgarisht UÇK-në dhe Kosovën, ashtu siç i kishte vrarë RDB-ja serbe disa herë edhe fëmijët serbë, për të na akuzuar UÇK-në si vrasës të tyre!

Nuk më takon ta këshilloj ZPS-në, por do të kishte qenë e dobi-shme, sikur ZPS-ja ta kërkonte nga DGSE-ja franceze dosjen për Hashim Thaçin, dhe nga BIA serbe dosjet për Bujar Bukoshin, Isa Mustafën, Ahmet Krasniqin, Tahir Zemajn, Xhavit Halitin, Azem

Sylën, Hashim Thaçin, Rexhep Selimin. Prokuroria dhe Gjykata e München'it e detyruan Kroacinë, përmes kushtëzimit të qeverisë kroate nga qeveria gjermane, për anëtarësim në BE, që t'i dorëzonte Zdravko Mustaqin, ish shefin e SDB-së së Jugosllavisë dhe këshilltarin e presidentit Franjo Tuxhman, dhe Josip Perkoviçit, ish shefit të SDB-së së Kroacisë, të cilët janë gjykuar në vitin 2014, në München, për urdhërdhënie për vrasjen e një kundërshtari politik kroat, i strehuar në Gjermani.⁶⁴ SHBA-ja dhe e BE-ja mund ta detyrojnë presidentin serb Vuçiç, që ta urdhëron BIA-n t'ua jep dosjet e personave të lartpërmendur.

Uroj që ZPS-ja ta vlerësojë këtë dëshmi të vetë-vullnetshme, të shoqëruar edhe me rrëfime dhe komente.

Nëse i duhet ZPS-së, jam i gatshëm të bëj edhe betimin ligjor për këtë dëshmi.

Jam i gatshëm t'iu përgjigjem të gjitha pyetjeve që mund të ketë secili prokuror i ZPS-së, për konkretizime plotësuese.

Do preferoja, protagonistët e zhvillimeve të atëhershëm të angazhohen për të korrigjuar ndonjë paskatësi në këtë tekst, apo edhe ata t'i ofrojnë informacion e dëshmi ZPS-së, sepse është e Republikës së Kosovës.

Ibrahim Kelmendi

Adresat për komunikim elektronik:

i.kelmendi@gmx.de dhe ibrahim.kelmendi@web.de

Kopja e faqës së pasaportës që i përmban të dhënat personale:

⁶⁴ <https://www.br.de/nachricht/prozess-olg-muenchen-perkovic-mustac-100.html>

